

Bahri

Myftari

BIBLIOTEKA
SHETIT

814-32

M 99

NJOHJE

tregime

814-32

M 99

BAHRI MYFTARI

NJOHJE

tregime



2776

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

N J O H J E

«... Këtë ngjarje e kam treguar dhe herë të tjera, po çdo radhë më duket më e re, aq sa kohët e fundit më është shtuar dëshira për ta treguar më shpesh...»

Nga biseda me një veteran.

Bënte një dimër i ftohtë, qiellit dhe tokës i shkonnin mornica. Po s'ishte kjo e keqja më e madhe. Të ftohtët është më i hidhur kur e ndien oxhaku dhe hambari, atëherë e gjithë e keqja të grumbullohet në bark dhe trupi të rri si mbi maja thikash. I tillë ishte dimri i 42-shit, që sapo kishte hyrë. Duheshin mbjellë të lashtat e vona. Kur shihja ndonjë rreze të zbardhte, nisesha për të punuar, po më parë kthehesha sesa shkoja. Një ditë largimi i reve nga maja e malit m'i shtoi shpresat, ndaj u nisa për të punuar në arë. Pa u afruar mirë, shtanga, përplasa dy-tri herë fort qepallat. Njëzet metra tutje, një gardh listelash kishte rrethuar tokën time. «Po kjo!?» Nuk vonoi shumë dhe një e qeshur që matanë gardhit ma drodhi trupin. «E qeshura e Xhelal Beut!» — thashë. Të qeshurën e pasoi një zë:

— Po çuditësh, ë?

Nuk u gabova, ishte ai. Pastaj ai vazhdoi:

— Të kemi vënë gardhin. Ke kohë që s'je kujtuar për mua, ti e di mirë: po nuk dhe, nuk merr, këtë duhet ta kishe menduar.

Iu afrova gardhit dhe u mbështeta mbi të. Po në atë kohë, dheu që ngritën plumbat më ra sipër këmbëve. U largova pak dhe dallova saktë dhëmbët e Xhelal beut dhe të atij tjetrit, që i rrinte në krah.

— Xhelal bej, — i thirra, — barku bosh e bën kokën të rëndë dhe s'e lë të mendojë. — E si heshta një çast shtova: — Mezi mbahemi gjallë, s'mbetet gjë për ty.

— Kështu ke thënë gjithnjë, — u përgjigj ai, — po ty s'të gjetka gjë. Edhe im gjysh të mban mend.

Kësaj here Xhelal beu u inatos.

— S'të lë të hysh në arë po s'më dhe ato që më ke borxh.

— S'kemi, Xhelal bej, s'kemi. Ti e sheh kohën, as ajo s'do.

Po Xhelal beu buzëqeshi dhe dhëmbët e verdhë prej metali dolën në shesh. Vendi s'më mbante, trupi sikur më ra në zjarr. Zgjata duart ndërmjet listelave dhe i ngjasha mbi dheun e arës sime. Ata qeshën prapë, duke lëshuar një breshëri plumbash. Duart s'desha t'i largoja pa i mbushur mirë me dhé, e, kur i mbusha, i tërhoqa drejt gjoksit. U ktheva nga rruga që më çonte më gjatë për në shtëpi.

— Babë, o babë! — më thërriste, duke më ndjekur nga prapa ime bijë.

— Ç'deshe këtej? — i thashë.

— Ato të shtënat, babë!..

Një damar sikur ma ndau ballin më dysh.

— Shkojmë në shtëpi, — më tha e trembur dhe më tërhiqte vazhdimisht për dore.

...Nga dita në ditë moti keqësohej. Era e bukës

s'ndihej fare në shtëpi. Listelat e ngulura në kurrizin e arës më ngjanin me korbata mbi trupin e një kafshe të plagosur rëndë, që kërkonin ta copëtonin ende pa ngordhur. Lart në qilar kisha një martinë të vjetër. Ditën e pazarit po pritja, dhe atë ditë u nisa. Në ditë pazari populli ishte mizë lisi dhe, për të hequr njo-llën e turpit, s'ka vend më të mirë.

Kur arrita, ishte mes pazari. Pazar i thënçin atij, se atëherë, atje, më shumë se dhjetë tasa me gjizë, disa plaçka të vjetra e disa copë pestili të thartë kumbulle s'kishte gjë tjetër. Megjithatë, grumbulli i njerëzve në atë kohë ishte i madh. Më ranë këmbët, po s'po e gjeja Xhelal beun. Ai në këso ditësh nuk rrinte pa bërë ndonjë belagji, ishte nga ata arinj që s'i mban dot strofka edhe atëherë kur kanë ç'të hanë. U err. Të mbeturat nga pazari po futeshin përsëri nëpër thasë për të marrë rrugën e kthimit. U shua edhe zëri i çjerrë i bakallit të fundit.

Vendosa t'i shkoja në shtëpi. «Pritmë, — thashë, — o Xhelal bej, pritmë!»

Hyra në lagjen e tij. Në të dy krahët e rrugës ishin shtëpi të ulëta, me çati të puqura, që vareshin si të mërzitura drejt kalldrëmit e që lartësoheshin vetëm te porta si dhe me dy dritare të mëdha që shikonin nga rruga. Nën ato dritare u ndala. Që andej, përhapej një vaj vdekjeje. U çudita e murmurita me vete: «Thua t'i ketë ndodhur gjë ariut që s'doli sot nga strofulla?» Shkova dy-tri herë lart e poshtë, gjersa u sigurova që vaji vinte nga ato dritare. Herën e fundit dikush më mbërtheu për krahu.

— Ik që këtu, or babë, — më tha. — Martinën e ke të gjatë dhe, ndonëse e ke nën gunë, si njeri i dytë të duket; ik, mos e ngatërro veten!

U ktheva se, nga zëri e njoha atë që më foli:

ishte Aliu, një bashkëfshatar imi, që e nxirrte bukën e gojës në kopshtin e beut.

— Ali, ti je, mor bir?

— Ç'bën këtu, or babë?

— Dua të takoj Xhelal beun, — i thashë.

Ai m'u afrua, sikur donte të më hidhte sytë e tij mbi ballin tim.

— A nuk dëgjon se ç'bëhet? — më tha. — S'ka Xhelal bej më, e pat puna e tij.

— Mbi kokën e tij ka rënë? — e pyeta. — Kush qe kjo dorë, si... e... qysh?!

— Partia! — tha ai.

— Hë? — pyeta unë, që asgjë s'po merrja vesh.

— Partia, pra. Ti sikur vjen nga fundi i dheut!...

— Ajo ngriti dorën. — Nejse, nejse. Ik, se nuk është vendi këtu për më shumë. Ik, ik, se takohemi një-herë tjetër e t'i them unë të gjitha. — Aliu vazhdimisht kthente kokën për të parë se mos na dëgjonte njeri. Kjo ma shtoi kureshtjen edhe më shumë. Në atë kohë u hap dera dhe u duk trupi i gjatë i italianit.

— I biri i putanës, — thashë, — e paska gjetur vëllanë? U largova disa hapa.

— Thuaja edhe një herë babës, Ali, kush e vrau? — foli me zë të ulët. Po nuk mora përgjigje. Aliu s'ishte më aty. Desha ta takoja përsëri Aliun, po s'munda, sepse ai kishte hyrë brenda.

Nata tani merrte frymë lirisht, këmbë njeriu s'kishte rrugës. Gjatë rrugës që të çonte në pazar sillja nëpër mend fjalët që më tha Aliu, po s'u jepja dot dum. U lodha dhe thashë ta pleqësoja edhe një herë kur të ulesha. Dhe në të vërtetë ashtu bëra. Gjumë në sy s'kisha se, kur mendja kërkon diçka, mposht edhe gjumin.

«Ali, — flitja tani me vete, — ç'ishin ato fjalë që the? Lajmin e pate të gëzuar, po nga ana tjetër po më bën të më fluturojë kapaku i kokës. Ç'është kjo dorë që vrau beun? «Partia», — the ti. — Po ç'është kjo? Qysh? Kaq thuhet, mor bir?! Ajo që vrau beun, pastë dorën e mbarë, po baba s'e le pa e gjetur. Se vrasësi i Xhelal beut është miku im, e miku i mirë duhet kërkuar, duhet njohur. Po, në fund të fundit, dhe po nuk e gjeta, unë do ta bëj timen: atë, birin e putanës, që ka bërë be për të vrarë mikun që vrau Xhelal beun, e çon baba nesër në atë botë. E miku, po të jetë burrë, do të më kërkojë mua, si e kërkoj edhe unë atë. Miku mikun nuk e bën hasha...»

Ja kështu e kalova atë natë të ftohtë. Ndieja të ftohtë, isha dhe i pangrënë, po diçka brenda sikur ma gjysmonte mundimin. Kisha tani një mik të ri, ndonëse ende të panjohur, që i kishte armiq armiqtë e mi. Do t'i laja patjetër hesapet me hasmin e mikut të ri. «Sa do të gëzohet dhe Fatimja kur ta marrë vesh».

Zbardhi. Dita rrugën e saj e filloi me erë të ftohtë, po aty nga mesi i pazarit era nuk ndihej shumë. Dyqanet ishin hapur. Kishte kaluar edhe Miliku, karrocieri, që bënte shakatë e para të ditës.

— Ku e ke dekoratën që të dha mbreti? — e pyeste kovaçi, më zevzeku, karrocierin plak.

— Ja, — përgjigjej Miliku, — ja, shikojeni, ia kam varur këtij, — dhe i binte me dorë vitheve të kalit, të cilat kishin formën e dy kërcunjve. Atëherë e qeshura shpërthente në të gjithë pazarin. Fillonte kovaçi i pari, që me të qeshurën e tij tundte llamarinën e vënë si strehë te dera e dyqanit e kalonte deri në buzët e shtrënguara të opingarit.

Ishte ende shpejt dhe italiani i gjatë, që ishte aga e bir agai, do ta kishte për ters të zgjohej që pagdhirë. Por, derisa gjithë ditën e kisha përpara, do të mundohesha se mos nxirrja ndonjë fjalë nga ndonjë njeri i saktë, që të mos ishte si Aliu, si ai çyryku nga fshati im. Të zotët e dyqanit i njihja pothuajse të gjithë, po më shumë fjala më hahej me kovaçin. Në të vërtetë ai ishte shumë më i ri se unë, po fjalën nuk e nxjerrin thinjat, po goja. Kovaçi ishte djalë i mirë. Punonte për merak kovaçi e pa hile. Sëpata që kaliste dora e tij, me një të rënë e ndante lisin më dysh.

Me kovaçin ndenja deri pasdreke vonë. Ia tregova të gjitha, por ai s'po hapte gojë. U tregua më gojëkycur se Aliu. Fillova të inatosesha me të. Aliu i varfër, ndoshta aq dinte e aq tha, ndërsa ky dukej hap-tas që dinte diçka më shumë, po nuk fliste. «E vrau Partia...» Po, hë de, atë e mora vesh, po kush më thoshte se ç'ishte kjo Partia?!...

— Mirë, or babë, — më tha ai më në fund. — Ik ti, nisu për në fshat e mos kujto se miku i ri nuk të njeh ty. Të njeh me rrënjë e me degë, sepse, ndryshe s'kishte pse të ngrinte dorën mbi kokën e Xhelal beut... Hallin tënd dhe të shumë të tjerëve qan ajo. Beu e kishte mbushur kupën si spiun i fashizmit.

— Atëherë, ku ta takoj? — i thashë.

— S'është një! — u përgjigj.

— Lëri këto, — i fola, — o më njih me Partinë, që ta pleqësoj punën e italianit të gjatë, o, ndryshe ti e more vesh rrugën që kam zgjedhur. Hasmi i mi-kut është edhe imi.

— Ik, — tha ai. — Me këtë martinë të gjatë, përveç ndonjë zullumi, asgjë tjetër s'ke për të bërë. Ikë, se dhe federalit, apo atij italianit të gjatë, miku yt

i ri ia ka vënë syrin, e, ndoshta pa vajtur ti në fshat, italiani do ta ketë marrë rrugën e Xhelal beut. Pastaj miku i ri ka për të ardhur vetë në shtëpi.

— Dua ta shoh me sy, — i fola dhe u çova.

— Si të duash, — më tha, — po më mirë lëre këtë punë. Së shpejti do ta njohësh edhe mikun që të doli krah.

— Kur të të zbardhet koka dhe ty, — i thashë, — atëherë do ta ndiesh më shumë se miku i mirë në ditë të zezë duhet.

— Në e quan tamam mik, atëherë dëgjoja fjalën. Ik në shtëpi dhe prite së do të vijë vetë të të takojë.

Ika, s'dija si të veproja. E kisha vështirë të hiqja dorë nga vendimi që kisha marrë, por ama dhe t'ia prishja mikut s'doja. Ecja e mendoja. Me kujdes, duke u munduar që të mos më binte në sy martina e gjatë, iu afrova qendrës së qytetit, ballë për ballë kafenesë që mbante një emër të ngatërruar, sa dhe sot s'ia them dot. Matanë xhameve dallova shtatin e gjatë të italianit dhe mbi rrobat e zeza të tij ca hekura të ndritshëm, që nuk mund të thuash se nuk i shkonin kodoshit, po sa para bënte, kur zemrën e kishte të zezë si pleh hajvanësh. S'e kisha vendosur... t'ia shkrehja te dera, sapo të dilte, martinën drejt në grykë, se atje e ka patur zakon kjo e uruar, apo të kthehesha në shtëpi.

Ia kisha ngulur sytë kafenesë dhe po pritja të dilte italiani. Italiani aty në qoshe me dy karabinierë të tjerë qe shtruar për shtatë palë qejfe. Shtrëngova rripin e martinës dhe po mendoja se si do ta priste miku im lajmin mbi veprimet e mia. — «S'do t'i vijë mirë», — tha kovaçi. «E pse? Po mbase ai mendon më mirë.» Isha në mëdyshje. Dëshira për të

mos ia prishur mikut të ri fitoi. Lashë vendin ku kisha zënë pusi dhe me hap të rëndë mora rrugën e shtëpisë.

Nga mesi i natës ndieva një trokitje në derë. Kur e hapa pashë kovaçin, Aliun dhe një djalë të vogël nga trupi, me flokë të dendur që s'e njihja.

Hodha sytë mbi të. Ai më qeshi dhe dy të tjerët vunë buzën në gaz.

— Hë, or babë, a e njohe mikun e ri? — më pyeti kovaçi.

— Po, — u përgjigja, — tani e njoha. Po ti ama, kur të pyeta, nuk ma tregove.

— Megjithatë Partia s'është një, — tha ai, — dhe unë e kisha të vështirë të të njihja. — Ata qeshën përsëri.

— Fjala e ëmbël e puna e mirë, — folta unë, — edhe miq më shumë do të ketë, i gjithë fshati im mik i saj do të jetë. Xhelal beu edhe diellin ishte gati të na e rrëmbente.

— I ka dalë hasmë i fortë Xhelal beut dhe të tjerëve, or babë.

— Pushka top, djemtë e babës!

Hymë brenda.

— Dëgjo, or babë, me ato listelat e gardhit ngrohu mirë ca ditë, se beu s'paska qenë fare budalla. Ja, paska menduar dhe për ty, prandaj shkuli pa merak, — më tha kovaçi.

Qeshëm të gjithë. «I shkula, — iu thashë, — dhe me ato po ngrohemi tani». Sytë na shkëlqenin të gjithëve, sepse më në fund e gjeta mikun e vërtetë nga i cili vetëm vdekja mund të më ndante. Dhe Fatimja, që në fillim rrinte si e druajtur, tani i dëgjonte duke buzëqeshur me sytë tërë shkëlqim.

NXËNËS DHE SHOKË

Nuk e di pse, po atë ditë më qe mbushur mendja top se s'kisha faj, megjithëse ata ishin ngritur të gjithë kundër meje.

«T'i hiqet patenta», — kishte thënë njëri.

Në sallë u dëgjuan ca pëshpëritje. Mua sikur më ra tavani. Atë që foli nuk e pashë. E njoha nga zëri. E kisha mësuar si të kapte timonin dhe ja sot ai, si pa të keq, tha: «T'i hiqet patenta». Pse s'tha «ta shembim në dru» a nuk është njësoj? Profesioni është një jetë e dytë. U ngritën edhe disa të tjerë, por njëri tha: «Që nga parku e deri në sektorin e sharrave janë mbi dhjetë klube, mjafton të hysh brenda e do të fillojnë të të merren mendtë nga alkooli dhe jo më të kthesh nga një gotë në çdo klub, siç bëri Jani». M'u duk sikur më nguli gozhdë në ballë. Gozhdë që më mbërthyen për ditë me radhë.

Dolëm nga mbledhja. Drejtori m'u afrua e më hodhi dorën mbi sup. M'u duk sikur mbaja bindën mbi kurriz.

— Mos u mërzit, djemtë të duan si gjithmonë, — më tha.

— Ti je gati të më hedhësh kudo, — i thashë.

— Burrat s'flasin kështu!

— Për ç'burrë më flet? — i thashë. — Ti u mbajte ison atyre.

— Ata kanë të drejtë, — tha drejtori. — Makinën e more të re në një kohë me të tjerët dhe e di ti si e ke katandisur.

Drejtori heshti për një çast. Unë s'po e duroja dot. Nuk e di, po fillova ta merrja inat edhe atë. U mblodhën shoferët e tjerë dhe e morën me vete.

Mbeta vetëm. «Nuk e mirëmban makinën; vërtet punon shumë, bën rrugë mbi normë, po ç'e do. Makinën e ka në pikë të hallit. Le pastaj që dhe sot u përplas dhe e theu fare...» Ata kishin vendosur që të mos kapja për dy muaj rresht timon me dorë. Do të punoja me lavazho.

«Hajde laj makinat e tyre tani, — thashë. — «S'e paske larë mirë, Jani», — do të thotë ndonjëri. «Edhe timen për djall e paske bërë». Pastaj do të qeshin».

Këto po mendoja, kur iu afrova shtëpisë por, meqenëse ende s'qe errur, bëra një kthesë e u futa në klub. Porosita për të pirë. Thonë se, kur je i mërzitur, pija të shijon më shumë. Po, të them të drejtën, unë s'po e shijoja. Tryezaq ishin me nga tre-katër vetë. Unë isha ulur i vetëm pranë derës. Shuajta cigaren në gjysmë, pagova dhe dola. Eca më këmbë dhe ngadalë, ndonëse autobusi qe në stacion. Kur arrita në shtëpi, ishte natë dhe njerëzit i gjeta në gjumë.

Të nesërmen u ngrita si zakonisht. Me të hyrë në park, m'u duk sikur të gjithë më shikonin mua. «Prit kur t'ia plasin gazit». Fillova pastrimin e makinës së parë po, për çudi, askush nuk qeshi. Makina e parë u la. Shoferi e ndezi atë dhe iku. Hyri një ma-

kinë tjetër. Uji rrodhi nga tubi dhe më lagu këmbët. E ndjeva, ishte shumë i ftohtë.

Aty pranë dëgjova ca zëra. Tubi i ujit m'u ngatërrua në duar dhe uji më ra në fytyrë.

«Filluan të qeshin», thashë. Hyra poshtë makinës. Ata nuk i shikoja. Zërat sa vinin afroheshin. Pritja me ankth ndonjë fjalë nga ata dhe mundohesha të bëja gati përgjigjen, po koka m'u rëndua dhe asgjë s'më vinte ndër mend.

— Na lage, — tha njëri prej tyre.

«Filluan», thashë.

Ata ishin lagur vërtet. Bënë disa hapa më tutje.

Tubi pësoi një përdredhje dhe doli nga hidranti. Uji filloi të rrjedhë. U zvarita e shkova për ta vënë përsëri. Para meje kishte shkuar Skënderi. Unë s'i fola, por ia shtyva duart dhe e vendosa vetë tubin. Skënderi më vështroi. Unë u largova.

Sa desha ta filloja punën përsëri, një tjetër më doli para.

— Usta, — tha ai, — kështu s'bën!

«Usta, — thashë me vetë, — usta, laje mirë makinën, fërkoje, për këtë je usta». Desha e i thashë këto fjalë vetë, se ai djali nuk zuri gjë me gojë.

— Ndize, — më tha Skënderi, që sapo u afrua.

Unë pashë përreth. Ata më shikonin mua.

— Mos i ngatërro gjërat, — tha Skënderi. — S'bën mirë që sillesh kështu!

— S'ju kam rënë në qafë. Ju ç'patët? — i fola unë.

— Ka ca rregulla, ti vetë na i ke mësuar.

— Tani që u rritët, përkrahni njëri-tjetrin dhe s'do mend, një të vetëm s'është vështirë ta mundësh.

— Ka ca rregulla, — përsëriti ai duke tundur kokën. — Kushdo që e tepron...

- Unë shikoja punën time.
- Ti mendon se të kemi inat! Mirë ne, po drejtori, po...
- Ata ju përkrahën ju, — e ndërpreva unë.
- Përkrahin të vërtetën, — tha ai.
- Atje ku u përplasa unë, mund të përplasej kushdo, — i thashë.
- Mundet, kur je...
- I pirë, hë?
- Pa dyshim, — tha ai.
- Por unë s'kisha pirë. Këtë jua thashë njëherë!
- Mos ngul këmbë kot! — tha një tjetër. — Në atë kthesë kalojnë tri Skoda!
- Ja, kështu veproni ju, — thashë, — bëheni një dhe lum ai që u provon mbi kurriz.
- Kot e mundon veten, — tha një i tretë.
- Ty të shkon puna si thika në dhjamë, — i thashë atij që foli i fundit. — Makinën e re dje e more, po të kisha dhe unë ndonjë të paktën si kjo, — dhe i rashë spondit të makinës që qe aty pranë, pikërisht te targa. Dora më mbeti mbi të e sytë i afrova më shumë. «Makina e Skënderit?!» — thashë. «Po ne të dy në një kohë i morëm.» — I turpëruar ula kokën dhe fillova punën. Pas pak Skënderi hyri në kabinë, ndezi makinën dhe u largua. E vështrova për një kohë. E kisha dashur mbi të tjerët. Vetë ia kisha mësuar zanatin. Atëherë ishte shumë i ri, flokëverdhë e me kaçurrela. «Të gjitha u harrokan, — thashë, — ardhka një ditë e u harrokan!» Prita të vinte ndonjë makinë, po s'erdhi. U ula dhe ndeza një cigare. «Dita e parë». Më erdhi inat me veten që kujtova ditët? Ato sapo filluan.

Pastaj erdhi dhe një makinë; e mbarova dhe atë së pastruari dhe me të i dhashë fund ditës së parë.

Kjo u përsërit edhe ditë të tjera. Djemtë më flitnin, por unë vetëm sa lëvizja buzët. Ndonjëherë grindesha me vete, po pastaj qetësohesha dhe e ndieja se inati sa vinte e më linte. Vetëm me njërin s'po ndahesha mirë; ishte ai djali që më kishte ngulur ato fjalë si gozhdë në ballë. Kështu vazhdoi ajo punë. Ditët rrokulliseshin dhe kaloi muaji i parë i dënimit. Një ditë po kthehesha nga puna, kur sa hyra në oborr të shtëpisë u ndesha me djalin. M'u duk i gëzuar. Kishte marrë çantën e sportit, duket shkante për praktikë.

— Ke ca ditë që vjen herët. S'e ke makinën në rregull? — më tha.

— Mirë e kam, po punoj afër. — Tëmthat më rrahën shpejt dhe diçka më zuri fytin, vazhdova të ecja.

— Kam kohë që s'të kam parë në stadium! — më tha. — Po munde, hajde sot. Kemi ndeshje kontrolli. Ekipi ynë shkon jashtë shtetit.

— E pastaj!?

— Hiç, — tha. — Ti, po munde, hajde.

U largua. Te shkallët qëndronte gruaja. Ajo na kishte parë.

— Pse i ndenje ftohtë djalit? — tha ajo. — Ai ishte shumë i gëzuar sot.

— Pse? Apo se i ikën ekipi jashtë shtetit?

— Me ta ikën edhe djali.

— Jashtë shtetit..., ë, — fola dhe lëshova një të qeshur.

— Se ç'ke ti, — më tha ajo duke dalë.

Hyra në dhomën time. «Këta s'janë në vete — thashë — fluturojnë! Apo kanë dëgjuar se ikin nje-

rëz jashtë dhe mund të ikë dhe ai, i biri i Jan shoferit». — Pastaj qesha. Siç dukej kisha qeshur me zë, se ndryshe s'kishte pse të hynte në dhomë gruaja, ashtu me sytë hapur nga habia.

— Ç'pate!?

— Ikën djali yt!... Edhe imi... ë?

— Pse të mos ikë? — tha ajo.

E mblodha veten. Fola:

— Bukur fort; ata sot kanë ndeshje kontrolli, apo jo?

— Nuk e di se ç'kanë, po di këtë, që ai do të ikë.

— Mirë, mirë. Po dëgjo, kanë ndeshje kontrolli; ngrihet njëri e thotë: të djalhtën e ka të dobët. Një tjetër thotë: kokën s'e përdor mirë. Çohet dhe një i tretë dhe aq. Më në fund edhe një tjetër dhe çdo gjë merr fund. S'kemi miq ne, jo. E, fol!?

Gruaja m'u duk si e ngurosur.

— Fol, — i thashë... — ë?

— Ke ca ditë që s'je në rregull, — ma priti ajo.

Ende s'ishte errur, po qejfi s'ma kishte të dilja.

Rashë në shtrat dhe gjumi më zuri shpejt atë natë. Nja dy herë isha përmendur dhe ashtu nëpër gjumë dëgjoja bisedën e gruas me djalin. Ata më përmendën shpesh. Më në fund gjumi më kishte mundur.

Në mëngjes te dera pashë djalin. Ishte ngritur më herët se unë.

— Baba, — thirri. — Baba, prit pak.

— S'kam kohë, jam vonë, — fola pa e kthyer kokën. Hapat m'u dukën të rëndë. Diku u ktheva dhe pashë djalin që qëndronte ende te shkallët.

Kur hyra në park, roja më tha:

— Hajde ngrohu pak, filloi të ftohët.

Unë vetëm e përshëndeta.

— Do të plakesh shpejt, Jani!

Unë prapë s'fola. Shkova te vendi i punës. S'pata shumë punë atë ditë. U mora më ca gjëra të vogla. Vetëm afër drekës erdhi një makinë. E mbarova dhe makina u nis. Vajta të mbyllja hidrantin e ujit. Atje u shtanga. Pashë djalin. Gati sa nuk rashë. Koka m'u këput mbi gjoks. M'u duk se një mjegull e dendur, që ngrihej nga toka, na ndante.

— A u lodhe, baba?

Tubi i ujit më ra nga dora. Ndjeva krahun e tij që më tërhoqi drejt vetes.

— Po munde të marrësh lejë, të dalësh pak më shpejt sot, — më tha.

— Si dolët dje në atë ndeshjen e kontrollit? — e pyeta pa e ngritur kokën. Kot e pyeta, diçka më brente më shumë se merakun i ndeshjes.

— Mirë, — tha djali dhe më kapi për krahu. — Mirë, ata tre që i kishe thënë mamasë nuk u ngritën e nuk thanë gjë.

— E... si... po, po, — fola kuturu.

— Kur s'ke gjë, s'kanë pse të flasin të tjerët.

Shtrengova dhëmbët sa më dhembën dhe sytë m'u zvogëluan.

— Mund të ikim, — i thashë.

Dolëm në rrugë. Urbanin s'e pritëm.

— Unë nesër nisem, — më tha.

— Për jashtë shtetit, — u çudita unë.

— Ty s'të besohet, baba? Ç'ka këtu për të mos besuar? I biri i Janit, i shoferit të parkut, Jani...

— I atij që lan makinat, — i thashë.

— Sot për sot, — tha. — Sepse gaboi, — dhe ma shtrengoi fort krahun.

«Gaboi», — murmurita nëpër dhëmbë dhe bashkë

BIBLIOTEKA E SHTETIT
GJEND. ASTER
2776
62212

me fjalën sikur më doli diçka tjetër që ma liroi gjoksin.

— Dhe ti do të ikësh jashtë shtetit, — fola duke drejtuar gishtin tregues nga ai me dyshim.

— Nesër, nesër, — tha duke tundur kokën.

Të mos e kisha djalin afër, do t'ia kisha veshur vetes me një grusht në gjoks. Aty diçka më rëndonte e doja ta nxirrja.

— Pse s'të besohet ty? — më tha fort e me vetulla pak të mbledhura.

Po e fyeja djalin me çuditë e mia dhe i thashë:

— Mirë, është shpejt të kthehemi në shtëpi. Shkojmë të blejmë diçka.

— Do të ishte mirë të thërritnim edhe ndonjë nga shokët e tu, baba.

Unë qëndrova. E kapa për supi. Ai më shikonte dhe qeshte.

— S'ma hedh dot mua, — i thashë, — po nejtse, ata këtu janë.

— Ti je i mirë, baba, — tha, më mbërtheu për shpatullash dhe më shtrëngoi fort.

Unë i rashë lehtë në faqe dhe shkuam drejt qendrës së qytetit.

Nuk u vonuam. Afër shtëpisë qëndrova. Disa të qeshura vinin që andej.

— E qeshura e Skënderit! — i thashë djalit.

Hymë brenda. Atje ishte Skënderi dhe tre të tjerë. Sapo hymë ne, ata morën një hije të rëndë e ulën kokat.

Lashë mbi tryezë ato që kisha në duar. Vështrova djalin e pastaj gruan. Ajo në fillim më pa me inat, po shpejt e tradhtoi veten dhe e ktheu kokën që të mos e shihja tek qeshte. Njëri nga ata u kollit.

Ajo pamje po më shkatërronte nervat, po kjo nuk zgjati.

E qeshura e Skënderit gurgulloi në dhomë. Ata qeshën të gjithë; duke parë ata, fillova të qeshja edhe unë.

— Hë, — tha Skënderi duke ngritur zërin. — Të kemi inat, — dhe erdhi e më ngriti nga divani, më rrotulloi dy-tri herë nëpër dhomë e pastaj më lëshoi mbi krevat. Të tjerët qeshën. Gruaja, tek më shihte ashtu, gati sa s'këputej nga të qeshurit.

— Shpejt, — tha Skënderi, — të shohim ç'na ka prurë!

— S'të ftoi njeri ty! — i thashë.

— Erdha vetë, — tha Skënderi.

Unë dola nga ana tjetër e krahut të Skënderit. Vajta në dhomën matanë dhe prura dy shishe të tjera. Skënderi e pregatiti shpejt tryezën.

— Tani të takon ty, — më tha.

U ulëm të gjithë rreth tryezës. Ngritëm gotat.

— Prit, — thashë unë e vura dorën mbi gotën e djalit. — Ti nuk duhet të pish.

— Jo, — tha Skënderi, — se përplasesh, — dhe pa nga unë.

Të tjerët qeshën.

— E pastaj të marrin shokët inat, — plotësoi gruaja.

Qeshëm përsëri. Pastaj përplasëm të gjithë gotat mbas asaj të djalit.

— Fitore, — thamë me një zë.

M J E S H T R I

Kishin disa orë që ata të dy po punonin dhe mjeshtri s'kishte thënë asnjë fjalë. Kjo s'i kishte ndodhur herë tjetër. Jo se mjeshtri kishte ndonjë dëshirë të madhe për të folur, po dhe ta qepte gojën si sot, s'kishte ngjarë kurrë.

«Ç'ka ky!» — mendoi Dani e i nguli sytë mbi shpatullat e mjeshtrit, të cilat lëviznin me kujdes mbi trupin e verdhë të broncinës.

Njëherë mendoi se mos padashje e kishte fyer, po jo. Mos vallë mjeshtri s'kishte dashur të punonte jashtë orarit, apo ngaqë sot kishin marrë rrogën dhe ai donte të shkonte shpejt në shtëpi? Dani qeshi me vete. Ai e njihte sot e një vit më parë mjeshtrin dhe për gjëra të tilla kurrë nuk mbante inat. Po, mund të mërzitej mjeshtri e të zemërohej, por ama vetëm atëherë kur lije orët e punës të të iknin kot, kur punën e bëje shkel e shko, e le pastaj po të ngrije zërin e të kërkoje më shumë se të takonin. Bile atëherë ai nxehej aq shumë, sa shpërthente: «S'ke të drejtë. Mos kërko më shumë sesa të takon, mate çdo gjë me djersën e ballit.» E kishte fjalën e tij këtë, «Me djersën e ballit». «Fjala e fjalëve», thoshte. E thoshin edhe të tjerë këtë fjalë, po në go-

jë të tij ajo kishte një tingëllim të veçantë, ndoshta ngaqë ai s'i bënte shumë teori kësaj fjale. Kur s'kishte në dorë ndonjë punë, mendja e tij diçka do të kishte filluar të kërkonte dhe jo shumë larg, një novatorizëm i ri do të nxirrte kokë në fabrikë.

— Ndoshta s'ia dalim dot! — belbëzoi Dani dhe vështroi përçark pak i habitur e pak i frikësuar. Iu duk se këtë radhë e fyeu mjeshtrin. Në fillim u step, po pastaj ai vuri paksa buzën në gaz, i kënaqur që mjeshtri s'kishte dëgjuar gjë. U bë gati ta pyeste se ç'kishte që rrinte ashtu. Po në atë kohë nga furra u dëgjua një e kërcitur e rreptë dhe Dani vështroi fytyrën e mjeshtrit, vetullat e tij që sulmonin njëra-tjetrën dhe sytë e futur thellë.

— Mjeshtrë! — foli Dani.

Ai, si të mos kishte dëgjuar gjë, mori rasketën¹⁾ dhe filloi punën mbi broncinë. Humbi i tëri në të. Sytë i ishin zmadhuar. Pastaj ia dha rasketën Danit dhe vetë ndezi një cigare. Me dy-tri të thithura e çoi atë afër gjysmës dhe e hodhi në dysheme. U largua.

Dani e vuri re. Tundi kokën dhe filloi të rasketonte barkun e verdhë të broncinës. Tymi i cigares së hedhur i tërhoqi vëmendjen, rreth saj kishte një numër gjysmash të tjera cigaresh.

«Çudi!» — foli Dani.

Mbas pak erdhi mjeshtri. I mori Danit rasketën e filloi të punonte. Ndërkohë ndaloi. Pastroi barkun e broncinës. Në mes ishte sajuar një vrimë e vogël.

— Po kjo, — tha ai i habitur, — ç'duhet kjo këtu?!

1) Vegël pune (përdoret për rrafshim sipërfaqesh të formave të ndryshme).

Dani e kishte sajuar atë pa dashje. I skuqur në fytyrë u ul të shikonte, po nuk mbërriti, diku tutje u dëgjua një tingull i hekurt, rasketa u përplas në dysHEME.

Dani e humbi. Mbeti ashtu gjysmë i kërrusur me sytë drejt saj. Gabimi s'ishte aq i madh. Pse të arrinte mjeshtri deri atje, sa ta fluturonte rasketën tutje?!

«Se ç'ka sot ky» — mendoi Dani. U ul. Ndezi një cigare. Ajo mbasadreke iu duk e gjatë sa dy ditë bashkë. Përballë kishte broncinën dhe ajo vrima që kishte sajuar pa dashje i vriste sytë. Pak më tutje, e shtrirë mbi dysHEME, qëndronte rasketa.

«Se ç'ka? — pyeti serisht veten Dani, — mund të më kishte qëlluar mua, po s'ma merrte mendja kurrë që të hidhte veglën e punës». Pastaj hodhi sytë drejt derës: mjeshtri qëndronte ulur dhe shpatullat i kishin formuar një gjysmë rrethi.

«Hodhe djersën e ballit», — murmuriti Dani pa ua ndarë sytë shpatullave të mjeshtrit dhe iu kujtua ajo ditë kur ai me disa të tjerë ishin ulur mbi kudhrën e kovaçit. Kur te porta ishte dhënë mjeshtri, si kishte ndaluar për një çast, pastaj, me të shpejtë, kishte vajtur drejt Danit, e, duke e tërhequr për supesh, i kishte thënë:

«— Mos u ul mbi djersën e ballit. Kjo këtu copë hekuri është, po derisa të jep të hashë dhe ti mbi të derdh djersën, mos u ul as vetë dhe mos lejo të ulet as edhe ndonjë tjetër». Kështu i kishte thënë mjeshtri atë ditë. Danit i kishte ardhur pak zor, se ishte i ri në punë, po megjithatë, bukën e atyre fjalëve e kishte futur në xhep. Prandaj kjo e sotmja e habiti. «Diçka i ka ndodhur sot këtij». Ky mendim filloi ta shqetësonte Danin.

Pas pak mjeshtri u çua. Ndezi një cigare e një ia dha Danit.

— Më fal, — i tha duke i zgjatur cigaren. — Më fal...

Dani i dha kokës lart dhe e vështroi në sy.

— Ç'është sot me ty? S'po kuptoj asgjë!

— Lëre, — tha ai e humbi përsëri në punë.

Dani u prek. Kishte menduar se kishte një afërsi të mirë me mjeshttrin. Bile edhe tani i po atij mendimi ishte, po ja... «Ka disa gjëra, — mendoj Dani, — në fund të fundit gjëra familjare... ku i dihet!»

Ndërkohë mjeshtri pastroi broncinën me kujdes. E kontrollloi mirë e mirë dhe vështroi lart. Nga furra të kërciturat vinin më të ashpra.

— Mbaroi? — pyeti Dani.

— Em, — bëri mjeshtri, — pse dyshove për këtë?

— Sot ku nuk më shkoi mendja, — tha Dani.

— Tani çdo gjë është gati, — tha mjeshtri, — mund ta montojmë.

Mjeshtri vuri pak buzën në gaz, e tundi kokën lehtë e po bëhej gati të ngrinte broncinën, po Dani e ndaloi.

— Këtë e bëj unë, — tha.

Mjeshtrit iu bë qejfi nga kjo fjalë, sepse sytë i qeshën po s'iu ndenj pa thënë:

— Megjithatë ti s'duhej të mendoje se nuk do t'ia dilnim dot, po nejtë, shkojmë e montojmë.

— Ti ke diçka, — tha Dani. — Me ty s'më ka ndodhur kurrë kështu! Pse s'flet?

Mjeshtri u tërhoq pak prapa. Filloi të lëvizte duart kot. Vetullat iu ngrysën. «Po ky ç'ka tani», po thosh me vete e nëpër dhëmbë foli:

— Që të dyshoje për punën, s'kishe arsye!

— Atëherë! — foli Dani, i cili tashmë e kishte nuhatur që tërë kjo mërzitje e mjeshtrit nuk kishte lidhje me dyshimin e shfaqur prej tij. Mjeshtri s'kishte nga luante, donte s'donte, e ndjeu se duhej të fliste. Dhe nuk vonoi shumë e filloi të flasë rreptë:

— Mirë, do ta mësosh të vërtetën? Do të sigurohesh që shkaku s'ishte puna e lodhshme për ndreqjen e broncinës, dëgjo: ti je shumë më i ri se unë si në moshë ashtu dhe në profesion, ama një kategori ke më pak se unë.

— Po! — tha Dani i çuditur.

— Dëgjo, dëgjo, ja ku dua të dal. Atë kategori që ke, ta falën, apo e ke merituar?

— Nuk të fal njeri, — tha prerë Dani, — e kam merituar. Me djersën e ballit e kam marrë.

— E pra! — i dha trupit para mjeshtri dhe i shtrëngoi supet Danit. — Me djersën e ballit, shumë mirë, me djersën e ballit. Të ta falte njeri, ti s'do ta merrje?

— Kurrë. Le që s'ta fal njeri.

Mjeshtri uli duart dhe foli rreptë.

— Ka disa shpirtmëdhenj, disa zemërmirë, disa...

Mjeshtri e ngriti zërin më lart, foli shpejt dhe fjalët iu ngatërruan nëpër dhëmbë.

— Nuk po të kuptoj! — tha Dani.

— Ke të drejtë. Le t'i biem shkurt, sot, kur mora rrogën, pashë se kisha lekë më shumë. U habita. Pyeta dhe më thanë se më ishin futur dhjetë orë plus. Ç'ishin këto?

— Ndonjë gabim! — tha shpejt Dani.

— Prit, s'ishte gabim. Mora lekët dhe vajta të takoja normistin. Hapa derën.

Ai më buzëqeshi e gjithë kënaqësi kapsalliti sytë. Dora m'u drodh dhe sytë m'u venitën dhe para

syve më doli një ngjarje. Para një jave normisti ynë më kapi në rrugë, kisha edhe djalin e vogël me vete. «Aman, më tha, Dalip. Më është prishur frigoriferi, hajde, të lutem e ma shiko, se ty të vjen ndoresh». Vajta. Defekti s'ishte kushedi çfarë. Normisti kishte një dhomë të mobiluar mirë. Përballë frigoriferit një alamet bufeje të këpuste sytë dhe brenda në të disa shishe pijesh sajonin një mozaik të bukur. Si mbarova, para se të ikja shefi na qerasi me karamele. Po ta them këtë jo se më mbeti hatri që s'më lëshoi ndonjë gotë, po... S'e di a më kuptove? e kam fjalën të «shpirtmadhësia» e normistit tonë. Tani si duket për të më shpërblyer për punën më ve dhjetë orë plus.

— Po ti i the..., — s'arrita ta mbaroja mendimin mbasi sytë e ngulur të mjeshtrit më bënë ta ndieja veten për së dyti faktor para tij.

— Edhe e vë në dyshim. Këtë e bëra problem dhe paratë s'i mora po më vjen zor. Pse të më ndodhte mua kështu. Më ke dëgjuar kur them se çdo gjë duhet ta fitosh me djersën e ballit? pa dyshim që më ke dëgjuar, e kur them kështu, rrah te rruga e ndershme dhe kështu kam vepruar gjithnjë, gjithë jetën time.

— Të njohin të tërë ty, ndaj mos u mërzit. Ka dhe ndonjë si normisti ynë.

— Kështu të desha, — e ndërpreu mjeshtri, kësaj here më i qetë dhe mbërtheu fort broncinën që rrinte shtrirë përdhe. Dani ndërhyri dhe e ngriti vetë.

Mbas një kohe ata bënë ndërrimin. Montuan broncinën e riparuar e dolën nga salla të lodhur, po të lumtur.

MIHALI

Ata ishin ulur në fund të bufesë. Ajo ishte një bufe e vogël prej pupuliti, e futur thellë mes malesh, pranë një sektori sharrash. Në verë e mbulonte gjelbërimi. Në dimër, kur bora mbulonte dheun, ajo dukej vetëm natën, sepse drita, si një pikë e verdhë, shpërndahej, ndonëse e zbetë, nëpër hapësirë. Nën këmbët e saj shtrihej rruga për në sektor, që zgjatej disa metra e pastaj fshihej prapa një kthese.

Bufeja prej pupuliti kishte vite që u qëndronte për bukuri të ftohtit, erës, shiut dhe borës. Pjesën më të mirë të ditës e kalonte e heshtur, e sidomos tani që kishte zënë bora dhe të ftohtët, po në darkë, ama, ajo gjallërohej, zhurmonte dhe nxirrte avull. Klientë të zakonshëm të saj ishin shoferët dhe sharrëxhinjtë që flitnin dhe qeshnin çiltër. Bufetieri ishte nga ato anë dhe më parë kishte punuar sharrëxhi. Ndoshta nga kjo ai i simpatizonte sheshit sharrëxhinjtë. Kur vinin ata, ai nxirrte një mangall plot me prush dhe e vendoste në mes të tryezave. Edhe kur e ngitnin shoferët, ai përgjigjej: «Ata e kanë hak».

Kur ndonjë e ngiste llafin më tej: «Meti, or babë, po ne, s'e kemi hak?» — ai thoshte:

— S'thashë atë, megjithëse ndonjë dhe e tepron. Shoferit, kur udhëton, duhet t'i vijë erë naftë dhe jo raki.

— Ndaj s'na jep veçse një teke raki? — Të gjithë qeshnim. Po, ç'është e vërteta, Meti për ne që bërë njeri i afërt. Të gjithë e donim dhe e respektonim. Po një natë ndodhi diçka e pahijshme.

Në një tryezë ishin ulur dy shoferë.

Nga fundi i sallës dëgjoheshin të qeshura, Meti që zhytur në punët e tij, kur papritur u dëgjua një zë:

— Bjerna dhe nga një tjetër, Meti!

Ai e dëgjoi saktë kush porositi, por iu drejtua tjetrit:

— The gjë, Mihal?

— S'e dija që të kanë lënë veshët. Desha dhe një konjak. Paskam të ftohtë sot, — foli ai që kishte porositur.

— Mjaft, Cen, — foli Mihali, — sot sado të pish, bile edhe sikur të notosh në konjak, prapë nuk mund të nxehesh.

Ceni e shtrëngoi fort gotën bosh e pastaj e përplasi mbi tryezë.

— Ti, Mihal, po deshe pi, po deshe...

— Jemi për rrugë, — tha Mihali. — Dhe kaq shumë është.

— S'dua të më japësh mend; ti po deshe pi, ndryshe...

— Të çohem! — e ndërpreu Mihali.

Ceni rrudhi sytë, i nguli ata mbi Mihalin dhe qeshi me djallëzi.

— Çohu, — i tha. — Çohu, çohu shko raporto. Shtroje në mbledhje, mua aq më bën.

Mihali s'foli, mbështeti bërrylat e ngjeshi këmbët mbi dysHEME, sikur do ta mbante ai pupulitin e ngarkuar të çatisë. Pas pak gota në dorë i krisi dhe një fije e kuqe gjaku i ngrohu dorën.

— Nuk them se ke pirë, po si i dehur fole, — tha Mihali që, për çudi, foli shumë qetë.

— Thashë atë që mendoj, bile ta thashë ca me vonesë.

Mihali u dha shpatullave prapa e foli:

— Nuk kam raportuar asnjëherë gjëra të paqena, as në mbledhjen e pardjeshme dhe as në ndonjë vend tjetër. Në qoftë se do të godasësh, fol haptas e mos e fshih dorën.

— Ajo që the pardje ç'ishte?! — tha Ceni e ndërkohë tymi i cigares mbuloi fytyrën e tij të hollë.

— E pritja, ti këtu do të dilje. Dëgjo, Ceni, në mbledhje fola për një problem që kishte kohë që më shqetësonte. Ne, domethënë unë dhe ti, ndonëse normën e kemi pasur dy rrugë në ditë, kemi bërë tri. Përderisa, ne mund të bëjmë tri, pse të mos i vëmë si normë, pra ta rrisim normën nga dy në tri? Kjo është plotësisht e mundshme, ndaj dhe shokët e pranuan njëzëri. Ti, e vetëm ti, dije këtë, ke që mbrëmë që grindesh, — foli Mihali, e sytë s'ia ndante fytyrës hollake të Cenit.

Ceni sepse qeshi dhe vari buzën e poshtme.

— Jua thashë, dhe mbrëmë — tha me një zë shpues, — dy rrugë ishin mjaft dhe këtë e kishin vendosur burra të tjerë, jo ti e unë. Ç'e di veten ti, Mihal? Si lart vret, po timoni ka vite që s'po të ndahet nga dora.

— Shko, ore, mbushu, — tha Mihali dhe u çua duke hedhur xhaketen mbi sup.

— Hë, shko, po t'u dha rasti thuaj dhe katër.

Mihali u kthye rrëmbimthi, po pastaj ndërroi mendje, shkoi në banak, pagoi dhe doli.

Bufetieri vështronte i habitur herë nga dera, herë nga Ceni.

— Bjer një gotë, — tha ashpër Ceni.

— Nuk të jap, — foli po me atë ton bufetieri, që deri atë çast s'e kishte hapur gojën. Dukej i nxehur. Një damar i ishte ngritur në ballin me rrudhë.

Ceni u çua e u mbështet mbi banak.

— Mbushe! — tha.

— S'të jap më. Mihali iku. Era pushoi, ç'pret më?

— Mbushe, more, more... mo...

— E çfarë?

— Kokë maloku, — shfryu Ceni.

— Ik, ore, mos na..., — tha bufetieri duke mos ia ndarë sytë Cenit.

Ceni hapi derën dhe doli. Mihali ishte nisur.

Ceni ndezi makinën, u zgjat pak prapa, nxori një shishe, e rrëkëlleu dy-tri herë dhe me mëngën e xhupit fshiu buzët.

Nata po e shtynte me shpejtësi ditën, sa të dyja makinat që po zbritnin të tatëpjetën, pa kaluar as tre kilometra, u detyruan të ndiznin dritat.

Mihali doli në një vend të hapur, vështroi nga prapa. Ceni nuk ishte shumë larg tij.

«Mirë, — tha me vete. — E dija që s'do t'i jepte më». E ndjeu veten të qetë dhe ndërroi marshin. Ecte me kujdes, se era që frynte nga kjo anë e ma-lit, e ngrinte rrugën e lagur dhe rreziku ishte pranë, si ta kishe në kabinë. Eci dhe ca, pastaj ktheu ko-kën prapa. Dritat e makinës së Cenit s'po dukeshin. Ngadalësoi shpejtësinë, hapi dritaren e krahut të tij. Prapë s'shihte gjë. Era me pika të ftohta shiu dhe

bore i rrahu fytyrën. «Ta marrë e mira, tha. — Pse s'po duket?» Zbriti poshtë. Të ftohtët i përshkoi trupin; shpatullat e gjera iu drodhën pak. — «Mos ngelsh kurrë vetëm këtej, — tha. — Cenit diçka do t'i ketë ndodhur». Filloi të ecte me të shpejtë deri lart në kthesë: «O Cen», thirri me gjithë forcën e zërit, po s'dëgjohej gjë, bile dhe vetë dyshoi për forcën e zërit të tij. Era e copëtonte të thirrurën dhe e mbështillte në krahët e saj. Bëri përsëri para. Diku ndaloi. Një dritë e verdhë i ra në sy. Kur pa që drita s'po lëvizte, ndjeu një shtrëngim muskujsh. Sytë iu zvo-gëluan dhe goja iu rrudh: nëpër dhëmbët e shtrënguar shpërtheu zëri: «Ç'ka ndodhur, ta marrë e mira? Ceni, Ceni!» Ndaloi pranë makinës; pjesa e përparme e saj ishte ngjeshur mbas shkëmbit.

Nga prapa u dëgjua një zhurmë, pastaj një e përplasur e fortë dhe zëri shpues i Cenit:

— Ja tahmaja e madhe.

— Gjallë je? — thirri Mihali që iu duk sikur nga toka dikush e ngriti lart.

— Po si të ndodhi? — Vazhdoi Mihali duke mos ua vënë veshin fjalëve të Cenit.

Po tjetri vazhdoi ashtu, si i vinte për mbarë.

— Kështu ndodh kur nxitohesh.

Mihali po e humbiste durimin. Një damar iu ngrit mbi ballë e ia ndau atë në dy pjesë. Iu afrua dhe e mbërtheu për gjoksi.

— Dëgjo, Cen, mos fol sipas oreksit, po mendoj fjalët kur i thua. Tri rrugë kemi bërë vazhdimisht, ti, unë dhe të tjerët. Pse s'e thua copë se të vjen keq ngaqë e treta tani nuk shkon atje ku shkonte? Po s'të lë njeri të livadhisësh si të duash.

Një gulç fryme iu përplas Mihalit në fytyrë dhe era e alkoolit i shpoi hundët.

— Kështu nuk bëhen tri rrugë, s'do mend, — dhe, si hapi derën e kabinës, nxori një shishe thujse të zbrazur kónjaku. Shishja që fluturoi drejt shkëmbit, krisi dhe copërat e saj u shpërndanë.

— Ç'ishte ajo? — pyeti i shtirë Ceni, dhe ndjeu një avull të nxehtë t'i vërshonte në fytyrë.

— Si do të bësh? — foli ftohtë Mihali. — Radiatori është dëmtuar, ka rrezik të digjet motori.

— S'e mbajta dot, rrëshqita. Shih ç'djall kthese është!

— E, e, s'e ka fajin kthesa, — tha Mihali. — Po të shpejtojmë, a ke kavo?

Ceni filloi të lëvizte. Kapërceu spondin e makinës dhe filloi të tërhiqte kavon që qe në karroceri.

Mihali buzëqeshi lehtë dhe shpejtoi të mirrte makinën e tij.

Mbas pak të dyja makinat të rimorkiuara kishin lënë të tatëpjetën. Ato shkitnin mbi asfaltin e rrugës kryesore. Rruga qe e thatë, me sa dukej shiut i ishin prerë këmbët diku lart e s'kishte mundur të zbriste deri në fushë, megjithëse koha ishte e vrenjtur e një re e zezë kishte pushtuar qiellin. Të dyja skodat hynë në park. Nata e errët dhe era e ftohtë i kishte mbyllur dyert e reparteve të tjera, vetëm nga ofiçina vinte, e përzier me erën, zhurma e makinerive. Skodat ndaluan e të dy burrat zbritën. Ceni u mbështoll mirë me xhaketën e mushamasë, vuri një kapelë në kokë e u nis.

— O Hysen! — thirri. Thirrja me ëmrin e plotë e çuditi dhe vetë Mihalin. Kishte kohë që ishte mësuar ta thërriste shkurt, «Ceni». — O Cen! — thirri përsëri thujse deshte të ndreqte gabimin e parë. Shpejtoi. Era frynte dhe ajo reja e zezë endej nëpër qiell.

Ceni dëgjoi që e thirrën po s'u kthye. Ecte, ose më mirë tërhiqte këmbët me mundim.

— Ku shkon? — e pyeti Mihali duke e mbërthyer për supesh. — Ta marrë e mira, ta marrë, pse s'pret?

Ata ishin komshinj dhe shpesh u takonte ta bënin rrugën bashkë.

Ceni s'po përgjigjej, dhe me sytë përdhe nxori paketën e cigareve.

— Ndize njëherë, — i tha Mihalit, dhe e zuri për krahu.

Morën të dy rrugën për në shtëpi. Frynte erë. Tashmë dhe ajo reja e zezë, kishte filluar të davaritej. Lart në qiell yjet dimërore dukeshin si zemra trëndafilësh.

DASMË ANDEJ E GRURË KËTEJ

Astriti donte që orët e para të mëngjesit ta gjenin në rrugën kryesore. Me rastin e martesës së motrës i kishin dhënë dy ditë leje. Ishin në vlagën e punës dhe makina e tij nuk mund të rrinte më shumë se dy ditë pa punë. Tani ecte, ose më mirë, vraponte. Vraponte dhe lodhje nuk ndiente. Në shtëpi e priste një gëzim i madh, për të cilin kishte bërë dhe ai diçka, madje më shumë se të tjerët. Vërtet që lodhje nuk ndiente, po rruga po i dukej tepër e gjatë. Ndoshta ngaqë atij rrallëherë i takonte të ecte më këmbë. Ai ishte shofer dhe, të udhëtosh mbi rrotat e makinës, s'është njësoj si mbi këmbët e tua. Diku dalloj rrugën kryesore, shpejtoi. Era i ftohu mushkëritë. Retë e errëta ishin gati të lëshoheshin mbi tokë. Kur doli në asfalt, ndjeu pikat e para të shiut që dalngadalë u shumuan. Nuk vonoi shumë dhe u dëgjua zhurmë makine, te kthesa u shfaq një Skodë. Astriti i ngriti dorën. Shoferi, si të ishte zënë në faj, ngriti të dyja duart lart. Astriti e përshëndeti e në atë çast mendoi: «Ushtarët janë udhëtarët e vetëm që i zënë ngushtë shoferët». Pas pak një Zis i ndaloi te këmbët.

— Hip, — i tha shoferi dhe i thirri atij që rrinte

në karroceri. — Qano, fute ushtarin nën mushama.
Astriti hipi.

— Për ku? — e pyeti ai që quhej Qano. — Apo me leje?

— Po, — u përgjigj Astriti. — Martoj motrën.

— Të të trashëgohet, — tha ai, — e në kokën tënde, o ushtar! Apo je i martuar?

— Jo, — foli Astriti dhe pyeti: — Po ju nga kështu?

— Ishim në L, — tha Qanoja, — morëm këta thasët me pleh. Duhet ky i uruar, duhet, gjithë bukë është. Në bokërrimat tona as gurë nuk mund të mbi-llje, po ja vjet, kur i hodhëm nga ky i uruar, ç'grurë patëm, det u bë!

Shiu u dendësua. Qanoja shkoi nga fundi i karrocërisë. Po mbulonte ca thasë të lidhur sidokudo. Me sa dukej, aty kishte hedhur ushqim që vetëm barku i tokës mund t'i bluajë. Qanoja u bë qull.

— A e di si e thith lagështinë ky, o ushtar, si i babëzitur, ja, si ai njeriu me buzët e thara nga etja, — tha Qanoja e erdhi u fut nën mushama.

Shiu vazhdonte. Qanoja s'po ua ndante sytë thasëve.

— Ecën avash ky i uruar, na plaku. Po nuk ka faj jo, është ftohur e kolla ia rrëzoi gjoksin përdhe.

— Keni kohë që jeni nisur?

— Pa zbardhur, — tha Qanoja, — por kemi ecur si breshka.

Makina ecte vërtet shumë ngadalë, aq sa kjo i mërziste. Mbetën një kohë pa folur, po Qanoja dikur e prishi heshtjen:

— A bëni dasmë ju andej? — pyeti.

— Jo, se s'e shitëm dot shtëpinë, — tha Astriti dhe qeshi.

— Mirë, mirë, si këto dasmat e reja them. Hap sytë, o ushtar, vëri sytë ndonjerës se, a e di si mbli-dhen çupëria në dasmë, mos e pyet, si delet rreth kripës.

Astriti qeshi.

— Më dëgjo mua, — tha Qanoja, — jam i vje-tër unë.

Ndërkohë filloi një erë e fortë. Qanoja u ngrit e bëri andej nga fundi. Degët e plepave kacafyteshin me njëra-tjetrën.

— Bobo... si e thith lagështinë, — foli Qanoja dhe erdhi u ul.

S'folën më. Ndoshta Qanoja mendonte për ple-hun. Lëvizja e ngadaltë e makinës po i mërzhiste. Po të vazhdonte kështu, Astriti s'e kapte dot trenin. Kjo ia shtoi shqetësimin. Makina diku ndaloi, Astriti kër-ceu më këmbë. Ndërkohë u hap dera e krahut të djathtë.

— E, mo Rako, ç'bëhet?

— Aliu s'është mirë, — tha Rakoja.

Qanoja me Astritin zbritën. Aliu ndihej me të vërtetë keq. Ishte zverdhur. Kolla i ishte rralluar, por ishte bërë më e thellë. Sytë po i zvogëloheshin dhe bula djerse ia mbuluan ballin.

Qanoja kapsalliti sytë. Astriti bëri mënjanë e mendoj se dita po i fluturonte në rrugë.

«Ta marr vetë makinën», mendoi, por e largoi në çast këtë mendim. Zhurma e një makine tjetër u dëgjua nga larg e pastaj u dha afër tyre. Shoferi i porsaardhur zbriti e kur pa Aliun në atë gjendje, u trondit.

— Pa e marrë veten, mos e lini të niset. Në fund të fundit lajmëroj unë në qytet.

Astriti vështroi makinën e ardhur. Ajo e kishte një vend të lirë.

«U nisa për në dasmë, mendoi Astriti, e ngela në majë të plehut. Duhet ikur. Me këtë makinë e kap trenin e shumë-shumë në drekë jam në shtëpi.»

Bëri për te makina e ardhur.

— Ik, o ushtar, ik! Ajo makinë e ka një vend të lirë. E shiko, tunde atje në dasmë, — thirri Rakoja.

— Si të vjen për shaka, o Rako, — thirri Qanoja. — U lagështit ky i uruar. Ç'të bëjmë, do të thuash, lëmsh të bëhemi. Krisje ke për të korrur këtë vit.

Astriti shtangu e ia nguli sytë Qanos që qëndronte në mes të shiut, me një thes në duar. Pastaj e futi thesin nën vete dhe po mundohej ta vendoste te vendi ku ishte ulur vetë më parë.

— Ushtar, do të vish? — u dëgjua zëri i shoferit.

Qanoja ndërkohë rrëshqiti dhe thesi e mori me vete. Astriti u hodh me shpejtësi e s'e la thesin të binte në asfalt.

Qanoja u ngrit me ndihmën e Rakos duke fërkuar kupën e gjurit.

— U vrave, Qano? — pyeti Astriti. Iu duk i afërt ai emër, si t'i kishte thirrur ndonjë shokut të tij.

— Nuk u treta, — u përgjigj Qanoja, — nuk u treta, po ky i uruar u bë lëng.

Shoferi thirri përsëri. Astriti i bëri shenjë që të nisej. Hyri në kabinë tek Aliu. Ai dridhej. Astriti hoqi kapotën, mbështolli Aliun mirë e mirë e shtrëngoi timonin.

«Të çoj plehun, — mendoi. — Më në fund shkoj me trenin e darkës! Më mirë vonë se hiç».

Ndezi makinën, i dha gaz dhe çau para.

— Oj! — bëri Qanoja mbi karroceri, — Rako, ç'bëhet?!

Të dy të habitur bënë drejt kabinës.

— Xhan, o ushtar, — thirri Qanoja duke futur kokën në kabinë. Uji që i kullonte nga koka ra mbi supin e Astritit. — Më të lumtë, — vazhdoi Qanoja, — të ardhça në dasmë!

Foli dhe më, por Astriti nuk mundi të dëgjonte. Kilometrazhi shënonte pesëdhjetë. Pastruesja e xhamit bridhte sa majtas-djathtas, duke larguar shiun. Po ecnin mirë. Zisi tërhiqte për bukuri. Vetëm gjen-dja e Aliut i shqetësonte. Atij buzët i kishin zënë një cipë dhe sikur avullonte i tëri. Menduan se do të ishte më mirë ta shtronin në spital. Mund të vonoheshin, po ç'rëndësi kishte ajo. Me të hyrë në qytet ashtu bënë, rregulluan Aliun e u nisën për në fshat. Lanë rrugën e asfaltuar dhe morën një rrugë të zhveshur përmes një luginë të thellë. Dita po thyhej, Astriti shpejtonte. Makina kishte tronditje të mëdha. Gropat ishin tërë ujë e ja, si të mos mjaftonte kjo, një bubullimë çau mbi luginë e solli një shi me shtamba. Astriti shtrëngoi duart mbi timon. Damari në tëmthat i ishte ngritur.

Ajo rrugë e vështirë u duk sikur mbaroi. Mjegulla që kishte rënë i ktheu orët e fundit të pasdrekës në një natë të parakohshme. Në fund të luginës dukeshin ca drita të dobëta. Shtriu krahët jashtë.

— Paska pushuar i uruari. U lodh, vu e vu gjithë ditën.

Astriti shkeli pak freksionin. Qerret që kishin kaluar aty pak më parë e kishin përzier baltën e

kishte rrezik të rrëshqitnin. Në fund të kësaj të ta-
tëpjete makina u trondit e frenoi në vend. Astriti
ndezi dritat. Para tyre një masë e madhe uji zhur-
monte.

— Përroi! — tha i habitur Rakoja. Ptu...

Astriti zbriti e bëri drejt ujit. Zbriti dhe Qa-
noja.

Një bubullimë e ca rrokullisje gurësh erdhën
nga gryka e luginës.

— Filloi, — tha Rakoja që, si u afrua, bëri të
zhvishej.

— Prit, — thirri Qanoja e kërceu i pari në pë-
rrua. Ecte me kujdes. U lag deri afër mesit. Astriti
vajti ndezi dritën dhe i ndriçoi rrugën. Qanoja me
vështirësi, po ia doli mbanë e që andej thirri:

— O ushtar, futu!

Astriti kërceu në tokë.

— Ç'thotë? — pyeti Rakon.

Qanoja thirri përsëri.

Astriti hyri në kabinë dhe iu përgjigj:

— Dasmë andej e gurë këtej, o Rako, — dhe
pastaj qeshi.

Rakoja qeshi dhe i ra supeve Astritit. Qanoja
lëvizi dorën që andej sikur t'i thoshte: «më burrë,
o ushtar».

Astriti ndezi makinën. I dha gaz e bëri para,
pastaj u kthye prapa. Rrotat kishin marrë baltë.
Ndërroi vendin dhe i dha makinës tërë gazin. Ajo
hungroi duke çarë ujin në të dy krahët.

— Na mori të keqen, — tha Qanoja matanë.

Filluan të ngjitnin atë pat të përpjetë. Një e
lehur qeni e ca blegërima përziheshin me zhurmën
e shiut, që nisi sërish.

— Tani le të bjerë, — tha Rakoja, — jemi në prag të shtëpisë.

Astriti u kollit thatë dhe e nguli shikimin diku. Mbas pak ata qëndruan. Te magazina i prisnin tre burra të tjerë. Astriti siguroi makinën. Në atë kohë Rakoja i futi krahun dhe i thirri Qanos. Ai erdhi në gast e doli në krahun tjetër të Astritit.

— Shpejt, — tha Rakoja, — shkojmë andej nga unë sonte.

Astriti qëndroi në vend. S'dinte si të bënte. Ishte bërë vonë, kështu që dhe trenin e fundit s'e arrinte dot, le pastaj që përroi kushedi sa do të që fryrë, megjithatë tha se do të provonte mos gjente ndonjë automjet të rastit, po s'e la Qanoja.

— Si, — u çudit Qanoja, — po përroi me se kalohet, apo me krahë?!

— Sot është e pamundur. Nisesh nesër që më sabah, — ndërhyri Rakoja.

— O ushtar, — foli Qanoja, — kjo është punë që s'bëhet. Mirë thotë Rakoja, nisu nesër që me sabah. Ndërsa sonte, — sytë e vegjël i buzëqeshën ëmbël, — e di ç'ke, do të bëjmë andej nga unë një dasmë të vogël. Xhan, o ushtar, mos u mërzit.

Astriti s'kishte ç'të bënte. Tani që e kotë të nisej.

Morën të tre drejt shtëpisë së Qanos. E kaluan mirë atë natë. Vonë ranë të flinin. Gjumi i zuri shpejt. Ditën ishin lodhur, po kishin fituar. Ndoshta atë natë Qanoja kishte parë ëndërr qershorin dhe hënën që u gëzohej lëmenjve.

Nga shtëpia e Qanos, Astriti doli herët. Mëngjesi ishte me erë dhe i bardhë. Qielli po pastrohej e nga majat e maleve retë filluan përsëndetjen. Rrugës, çanta Astritit iu duk e rëndë. Diku e hapi dhe pa

brenda në të një kulaç. Qeshi e shpejtoi hapin. Rruga për në qytet s'qe aq e shkurtër sa e kishte menduar ai. Megjithatë, për të kapur trenin e paraditës kishte kohë. Herë-herë çlodhej ose ngadalësonte hapin. I bëhej sikur dëgjonte zhurmë makine e pastaj qeshte me vete. Ai, makinën e vetme të kooperativës e kishte çuar vetë një natë përpara,

Kur vajti në qytet, treni ishte gati për nisje. «Po të nisem me këtë tren, për të vajtur vete, po për t'u kthyer në repart, s'kthehem dot sot».

E fërshëllyera e trenit u dëgjua përsëri, por ai kësaj radhe nuk lëvizi. Treni u nis. Astriti po e përcillte me sy. Udhëtarët ishin të gëzuar. «Tamam si dasmorë», tha Astriti. Vuri buzën në gaz e u kthye.

Afër qendrës së qytetit ndaloi. Tingujt e sahatit të madh ranë njëmbëdhjetë. «Vera tani ka vajtur në shtëpinë e saj të re», mendoi Astriti.

Një ëmbëlsi i valëzoi nëpër trup e vrapoi. Vrapoi e hyri në postë. Mori atje një tekst telegrami e shkroi: «Vera, të trashëgohet — Astriti». Pagoi dhe doli.

NË RRUGËN E VËLLAIT

Ishin bërë katër muaj nga dita që kisha mbaruar gjimnazin, po në punë s'kisha hyrë ende. Jo se nuk gjeja, po doja një punë që, siç mendoja unë atëherë, të më justifikonte shkollën. Kohët e fundit tekave të mia po u dilte boja. S'më linin rehat nëna në një krah, e në krahun tjetër vëllai, aq sa një ditë ai s'la gjë pa më thënë: «Pse i bën naze punës? Ç'është kjo mendje! Unë çfarë jam, që tetë orë rri mbi timon? Në fund të fundit, vëlla i dashur, po nuk punove, as për të ngrënë nuk mund të gjesh!»

«I qenkam rëndur», mendova dhe vendosa:

«Mbasdite do të shkoj në zyrën e punës». Dhe ashtu bëra. Nëpunësi ishte po ai që kisha takuar dhe herë të tjera.

— Çudi me ty! — më tha, kur më pa përballë tryezës. — Puna të thërret e ti s'do. Në atë kantierin e ri, buzë Shkumbinit, kanë vajtur edhe djem të tjerë, shokët e tu. Ti ç'kërkon? Urdhëro merr karri-gen time, por po të them, djalë i mbarë, që mos ma ki zili. Ti je i ri, ke forca e ke nevojë për diell, për ajër, për lëvizje. Ç'djall të shtyn që kërkon të futesh brenda katër mureve?

— Flet nga karriçia, — i thashë.

E pashë që s'i erdhi mirë. U çua, bëri disa lëvizje nëpër zyrë. U ul përsëri. U fut në ato dokumentet që kishte përpara e më s'foli.

Hapa derën e dola në korridor. Korridori m'u duk i ngushtë dhe i errët. Shpejtova hapat. Jashtë shiu vazhdonte të binte dhe era që vinte nga lindja ishte bërë më e rreptë. Eca. Ecja dhe ndieja shiun të më hynte në trup. Të ftohtët po egërsohej. Në rrugë s'kishte njerëz. Shpejtova e hyra në birrarinë aty pranë. Te dera takova një nga shokët e mi të gjimnazit. Kur mori vesh se s'kisha filluar ende punë, më foli si t'ia kisha borxh: «Vret lart ti», dhe iku.

Një burrë që rrinte te një tryezë pranë derës më thirri e duke qeshur më ftoi të ulesha.

— Qenke i mërziur, — më tha. — Kërkon të futesh në punë?

— Po, — i thashë dhe vetë mendova i turpëruar. «Duket e dëgjoji çfarë tha Skënderi». Tymi i cigares së tij më dogji hundët dhe gati sa nuk teshtiva.

— Nuk ka, — tha ai. — Është hapur një kantier i ri buzë Shkumbinit, nuk e di, a të kanë thënë për atje? Po pse, punë është ajo? Në breg të lumit nuk rri dot në korrik e jo më tani në mes të dimrit.

— Atje më kanë thënë të shkoj, — fola duke u ngjeshur pas karriges.

— Ke mbaruar gjimnazin? — më pyeti.

— Posi, kam dymbëdhjetë vjet shkollë... po ç'i do... apo për të ngarkuar zhavor.

Ai fërshëlleu e foli.

— Dymbëdhjetë vjet janë goxha! Dhe ata të thonë shko ngarko zhavorr. Ha, ha... — qeshi e vazhdoi. — Ata që të thonë, për vete nuk kanë parë punë me sy. Edhe mua ashtu më kanë thënë, të shkoj në kantierin buzë Shkumbinit... fjalë është ajo! Dë-

gjo, në fshatin këtu afër unë po shtroj dhomat e shtëpisë së një fshatari, a do të vish si ndihmësi im? Mund të gjeja dhe ndonjë tjetër, por... Njeriu pa para edhe në gusht mërdhin.

— Është larg? — e pyeta.

— Më të errur jemi në shtëpi, — tha ai e u çua. — Kështu e lëmë, nesër në mëngjes takohemi te stacioni. E... gati harrova, si të quajnë?

I tregova emrin, e si më tregoi dhe ai emrin e tij dolëm jashtë.

Ishte errur kur u ndamë me njëri-tjetrin. Njerëzit në udhë ishin të rrallë; e vetmja udhëtare ishte era e ftohtë që ta rrëzonte hundën përdhe.

Hyra brenda. Nëna, me sa dukej, kishte rënë të flinte. Te dera e kuzhinës u shtanga: mbi tryezë ishte vetëm një racion gjellë. Herët e tjera gjeja dy: një për mua e një për Durimin. Po ja, atë darkë ishte vetëm një. Tëmthat më rrahën fort dhe diçka m'u mblodh në gjoks. «E paskan vënë në zbatim që sot, — mendova. — «Po nuk punove, as për të ngrënë nuk mund të gjesh!»

Ndërkohë u hap dera e dhomës tjetër e që andej erdhi zëri i nënës:

— Pse rri më këmbë? Ulu ha. Durimi do të punojë në Stravaj këto dy ditë. Hëngri darkën më këmbë dhe iku. Ulu, bir, ulu, apo është e ftohtë gjella?

Pa folur u ula. Te dera ajo u kthye.

— Dëgjo, — më tha, — Durimi më porositi që nesër të vesh në park. Në oficinë kërkojnë nxënës.

— Gjeta punë, — foli. — Nuk është nevoja. Atij faleminderit për ato fjalë që tha.

Ajo, duke u çapitur, m'u afrua e më vuri duart mbi supe.

— Durimi të ka mbajtur në krahë, të ka rritur dhe do që të bëhesh i mirë, ndaj të flet. Nuk më beson mua ti, budallai i nënës. Hë, ha bukë e mos fol si fëmijë. Natën e mirë bëfsh!

Ajo u largua; as unë nuk ndjenja më. Ndieja një dhembje në kokë. Gjumi më zuri vonë.

Në mëngjes ajo ishte ngritur më herët se ditët e tjera e më kishte përgatitur një çantë plot me ushqime.

— Me krahë të lehtë e me nder, — më tha te dera e pastaj më përqafoi sikur të më niste për në ndonjë vend të largët. — Të futi nëna edhe ty në radhën e burrave. Ç'dua unë më shumë!

U ndava me të. Te stacioni takova Demirin. Tymi i duhanit të tij më dogji deri në mushkëri.

— Esëll e paske ndezur?

— Duhani esëll ia kalon një ëmbëlsire, — m'u përgjigj.

Hipëm në autobus. Kur zbritëm, moti ishte i ftohtë. Re të errëta kishin marrë vrapin drejt përrëndimit. Fshatari kishte ndezur një zjarr në mes të konakut e na qerasi me nga një filxhan qumësht. Demiri e piu duke turfulluar, e, kur mbushi të dytin, më shkeli syrin si të më thoshte: «o burra, mbushhe edhe ti».

— Hë, — i tha Demiri fshatarit, — sot mos ki merak, prandaj e mora këtë djalin.

— Aman, — tha fshatari duke parë herë Demirin, herë mua. — Ky i uruar dimër e kaloi pragon e sot e nesër në oxhak e ke.

Demiri qeshi e i kënaqur fshiu buzët.

— Prandaj i shtuam forcat, — e përsëri qeshi.

— E më ju lumshin duart! — tha fshatari e u largua.

Filluam nga puna. Vërtet që jashtë bënte ftohtë, po ne, që kishim zjarrin prapa kurrizit, nuk ndienim gjë. Dërrasat ishin punuar me kujdes e puthiteshin lehtë. «Mos u ngut, — më thoshte herë-herë Demiri, — mos u ngut», dhe herë pas here vinte e fërkohej pas zjarrit e më tregonte ndonjë «episod» nga jeta e tij. Tani unë s'i mbaj mend më ato, me përjashtim të një «historie dashurie», siç e quante ai. Vajza nuk kishte pranuar, se donte një tjetër.

«Por unë s'e lashë me aq, — tha Demiri. — Mua të mos më pranonte ajo, ha, ha, — qeshi ai. — Si kam qenë unë atëherë! Një ditë e pashë krah për krah me një tjetër. Më erdhi zogu te dora e më t'i hyra: «po ti, moj, ti, që deri dje ishe në krahët e mi...» ha, ha. Ai derdimeni rrinte në krah e s'e hapte gojën, po le ta hapte po të donte. Panë ç'panë e fësht ikën. Mirë ua bëra tha po vetë Demiri, aq mirë, sa s'më harrohet».

Pasdreke vonë e mbaruam gjysmën e dhomës. Kur u nisëm, dalngadalë po binte mbrëmja dhe një ngjyrë gri i ra faqes së fshatit. Aty-këtu po ndize-shin dritat. U ndezën dhe ato të klubit të koope-rativës.

— Hyjmë e kthejmë nga një gotë derisa të vijë autobusi, — tha Demiri.

Hymë, po gota solli gotën dhe radha e solli të ktheheshim me autobusin e fundit. Kur hymë në qytet, era fërshëllente e kacafytej me degët e selvive. Me të takuar me erën, një marrje mendsh ma drodhi trupin dhe stomaku sikur m'u shkul.

— Mbahu, — tha Demiri, — mbahu se desh e përqafove selvinë... Si t'u duk, ha, ha, ha... si t'u duk?

E mora veten e kur u ndamë ai më futi një njëzetepesëlekëshe në xhep.

Në shtëpi dritat ishin shuar, po me të ngjitur shkallët, nëna, si të më kishte ndier hapat, ndezi dritën e u dha të dera.

— Ç'u bëre, mor bir? Ma le mendjen jashtë. Ke që në pikë të mëngjesit që ke ikur. Ku qenka kjo puna jote?

— Punë, — i thashë. — Kudo ka punë, apo jo?

— Mirë, mirë. Pa hajde ulu, ha njëherë.

— Nuk dua, — fola, e mbi tryezë lëshova njëzetepesëlekëshin.

Ajo i nguli sytë mbi të.

— Ç'është kjo?

— Ai që punon merr lekë.

Ajo vuri duart në gjoks e vështroi përçark.

— Po Durimi nuk merr lekë çdo ditë! Ç'qenka kjo punë! Ti pse i marrke që ditën e parë?

Mua ma dha koka përsëri e vajta u shtriva. Nëna kishte mbetur më këmbë në mes të dhomës. Ndoshta s'dinte ç'të bënte. Heshti. Pastaj erdhi e më vuri dorën mbi ballë.

— Mos bjer pa ngrënë, — më tha. — Hajde, gjellën e ke valë.

— Nuk dua, — thashë.

Fryma ime i rrahu asaj fytyrën e ajo e trembur u tërhoq prapa.

— A, kështu jo, jo, jo. Ç'është kjo? Paske pirë, mor bir? Yt vëlla s'e ka bërë asnjëherë këtë, po ti pse, pse...!? Ç'është kjo e keqe?!

Lotët i rrodhën nga sytë dhe iu penguan nëpërrudha.

Nuk më foli më. Iku duke lënë pas një fëshfë-

ritje të hollë. Gjumi më zuri vonë e në mëngjes kokën e ndieja të rëndë. Nëna ishte ngritur dhe ndiqte e habitur lëvizjet e mia.

— Sot mos shko, ç'qenka ajo punë ashtu! Pastaj vjen dhe Durimi e fol njëherë me të.

— Tani jam në punë, — i thashë pa e parë.
— Prit tët vëlla.

Unë nuk fola e u bëra gati të dilja. Ajo u ngrit nga nimi, rrëmbeu njëzetepesëlekëshin atje ku e kisha lënë një natë përpara e ma hodhi nga prapa.

— Merre këtë, merre...

Ajo diç foli, por unë përplasa derën pas vetes dhe e mbajta frymën në stacion.

Demiri, me të më parë, ma bëri me dorë e hipëm në autobus.

Unë u gjenda përballë faturinos. E vështrova atë. S'ishte faturinoja e djeshme. Kjo më dukej si fytyrë e parë. Ishte grua e bukur, po ajo që të binte në sy, ishin buzët e saj të përthyerë e më të kuqe se lëngu i qershisë.

— Me mua fole? — e pyeta, me sytë mbërthyer në fytyrën e saj.

— Mos je i vëllai i Durimit? — më pyeti.

— Po.

Ajo s'foli më. Unë bëra përpara deri te Demiri. E ndjeva vështrimin e faturinos.

— Demir, — i thashë, — a e njeh atë faturinon?

— Kam pasur të bëj me të, — tha ai prerë e qeshi ha, ha... — Histori e vjetër dashurie, — qeshi përsëri dhe buzët e plasaritura i shkuan vesh më vesh.

Nuk e besova këtë radhë. Nuk e di pse s'e besova. Ndoshta ngaqë sytë ndeshën menjëherë fytyrën e bukur të faturinos.

Edhe kur zbritëm faturinoja na vështroi. Sytë e saj shprehnin përcmim. Unë ktheva edhe një herë kokën prapa. Shikimi i saj na ndiqte ende...

Fshatari këtë mëngjes na priti me këmbët e para.

— Dje gjithë ditën ishit shullërë pas zjarrit. Punë pa bereqet kishit bërë. Vetëm pesë copë dërrasa! Pse, o Demir, kështu, unë të qava hallin, a nuk i sheh plaçkat nëpër këmbë?

— Unë nuk mbjell qepë, — tha Demiri, — as patate nuk po shkullim, more vesh, mora thuaj!

M'u duk sikur Demiri u nxeh po në atë kohë, ndërsa mua më shkeli syrin fshatarit i foli:

— A do punë që të të ngelin sytë, apo do punë që të përdredhësh buzët?

— Shtëpia nuk bëhet vit për vit, — tha fshatari e u largua.

Mbetëm të dy. Demiri sot po më dukej më i shkathët. Rrëfimet e tij s'ishin shumë të gjata. Afër drekës pothuajse dyshemesë po i vinte fundi.

— T'ia mbarojmë sot njërën, — tha Demiri, — që t'ia mbyllim gojën. Oj, të mos ketë mend fare njeriu, vjen e të qan hallin e plaçkave. Po ne ç'të bëjmë! Bie shi jashtë, or babaxhan, nuk po bie diell e të vemi buzë Shkumbinit. Si thua ti, fol, fol po deshe.

Unë tunda kokën dhe qesha. Nuk fola. Ç'të flitja. Demiri vetë pyeste dhe vetë përgjigjej.

Kur dolëm nga shtëpia e fshatarit, shiu ishte i imtë, po pa bërë mirë hapat e parë ia dha me të madhe dhe ne të dy e lamë frymën te klubi i kooperativës. Aty brenda, përveç tre fshatarëve që ishin ulur te tryeza pranë këndit, s'kishte të tjerë. Unë me Demirin u ulëm në tryezën përballë derës së jash-

tme. Pa kthyer gotat që kishim porositur, përpara derës ndaloi autobusi. Pas pak pashë atë faturinon e bukur që zbriti e bëri disa hapa para. S'po ia ndaja sytë, kur ja një Skodë që erdhi ma fshehu. Spondi mbante numrin e makinës së vëllait. U ngrita paksa nga karrigia. Nuk isha gabuar, ai ishte. U takua me faturinon dhe ajo diçka i tregonte me dorë në drejtim të shtëpisë ku punoja unë me Demirin.

Vëllai ndezi makinën dhe u nis andej nga e drejtoi faturinoja.

— Vëllai, — thashë duke parë nga Demiri, i cili gjithashtu po shikonte nga rruga.

— Ai, shoferi? — tha Demiri. — Më duket se e njoh, mos ka qenë futbollist?

Unë pohova me kokë.

— Po pse të ketë ardhur?! — pyeta.

Demiri qeshi e duke përplasur gotën pas simes foli:

— Je akoma i vogël ti, nuk e pe me kë u takua, po hajde mos e vrit mendjen shumë. Për atë faturinon mund të shkosh deri në fund të dheut e jo deri këtu.

Unë shtyva gotën tutje e ia ngula sytë atij. Po t'i kishte dëgjuar këto fjalë vëllai, Demiri do ta kish-te paguar mirë.

Ndërkohë një zhurmë makine hyri në klub. Te dera u dha vëllai bashkë me një shokun e tij, Nasin. Ata bënë drejt nesh.

Durimi më vuri dorën mbi sup e foli:

— Po ti, ç'do këtej? Ë, ç'do?

Unë e pashë në sy e s'po flitja dot.

— Ulu, ulu, — foli Demiri, — e mos i bërtit, se është i lodhur.

— Kemi nja pesë vjet pa u parë, — iu kthye Durimi atij. — Akoma në atë rrugë je ti?!

— Të punosh mos është ndonjë gjë e keqe? — tha Demiri e ndezi cigaren.

— Të punosh është nder, por të mashtrosh...

— Iç, or, shiko punën tënde! Ç'je ti?

— Ku i gjete dërrasat? — pyeti rreptë Durimi.

Unë ktheja sytë herë nga njëri, herë nga tjetri. Vëllait, fjalët i dilnin shpejt, ndërsa Demirit sikur i pengoheshin nëpër dhëmbë.

— Ti je shofer dhe s'je polic, — foli Demiri e u çua.

Supi i djathtë sikur po më shkërmoqej, dora e shëndetshme e vëllait ma shtrëngoi më fort atë.

— Lëri këto, — foli Durimi, — dërrasat ku i gjete?

— I kishte fshatari, — tha Demiri e i dha trupit para.

— I kishte fshatari? Po unë sapo fola me të!

— Gënjen, — u dëgjua një zë nga prapa. — Unë s'kam pasur dërrasa.

Ne kthyam kokën prapa. Te dera ishte fshatari që shkundi opingat e duke folur erdhi drejt nesh.

— Bashkë e biseduam, o shoku shofer, apo jo? Unë s'kam pasur dërrasa. I thashë t'i bleja, po ky s'deshi. «I blej unë, — më tha, — ti vetëm lekët më jep». I besova si burri burrit.

— Turp, — thirri Durimi, — turp, — e gjithë forcë u vërtit përreth. Pastaj ato duart e tij të shëndetshme u ngjeshën mbi mua e më ngritën peshë. — Shporru, dil jashtë!

Ndërkohë erdhën edhe ata fshatarët që rrinin te këndi e unë u zvarita prapa supeve të tyre.

— S'ka faj djali, — tha i zoti i shtëpisë, — bisk i njomë ai, po ky, ky lisi i rrëzuar.

— Mos më çaj kokën, — tha Demiri e bëri para, — maloku i...

Fshatari u bë gati ta pështynte, po s'mundi. Ndërkohë vëllai e mbërtheu për xhakete Demirin, e qëlloi dhe e përplasi mbi dysHEME.

— Durim! — thirri Nasi dhe e mbërtheu për shpatullash.

Hynë dhe fshatarët në mes.

— Ndyva duart, — tha vëllai, — po nejse, ashtu e do ai.

— Dëgjona ne, shoku shofer, — tha njëri nga fshatarët. — Mos u bëj merak, se do t'ia gjejmë ne fillin këtij. Ky, më sa duket, e paska në thua këtë punë. Hajde ti, vetëm për një gjë do të të lutemi: atë djalin, vëlla, a çfarë e ke... lëre, s'ka faj ai...

Nuk vonoi shumë dhe Skoda u nis. Në kabinë ishte qetësi. E vetmja zhurmë ishte kërcitja e shiut mbi të. Po këtë heshtje dikur e prishi Durimi:

— Kur të tha nëna që të mos vije sot, pse s'e dëgjove? Dhe s'mjafton kjo, po shtrohesh për të pirë përsëri. Nëna mbrëmë kishte qarë... Po më dëgjo mirë, me mua edhe mund të zihesh, po për të, ama jo. Duhet të të vijë keq dhe turp... Pa le po i kishe dhënë edhe atë shpërblim të ndyrë.

— Ti më the, — i thashë unë. — Nuk duhet të m'i kishe thënë ato fjalë... — Pa mbaruar fjalët mirë, e kuptova që gabova. Nasi më këputi një bërryl në brinjë.

— Si, si të thashë unë, si të thashë, të punosh me... me atë maskaranë. Kështu të thashë? — foli Durimi dhe frenoi Skodën. — Hajde, hajde, po flet tamam si fëmijë. — Vetullat e vëllait ishin mbledhur. Hapi derën e Skodës dhe thirri: — Zbrit, hapu Nasi, hapu të zbresë.

Nasi pa nga ai. Ata e njihnin mirë njëri-tjetrin.

— Bie shi, Durim! — foli butë Nasi.

— Hidhu, hidhu! — thirri vëllai.

Unë kërceva në rrugë. Skoda u nis. Tymi i saj më rrahu fytyrën.

Mbeta vetëm në mes të rrugës dhe shiut. Durim!
— fola nëpër dhëmbë. — Durim! — thirra më fort.
Skoda s'po më ndahej nga sytë. Durim! Një ngroh-
tësi ma pushtoi gjoksin. E ndjeva që e kisha tepruar,
aq sa e kisha bërë të humbiste durimin. Fillova të
ecja. Të parët m'u trubullua. Tani doja ta kisha afër,
doja t'i flitja. — O Durim! — e vrapova me të shpejtë
prapa makinës. Sytë m'u lagën, ai s'ishte ujë shiu,
sepse ishte më i ngrohtë por unë nuk e fshiva. Trupi
m'u lehtësua. Vrapova edhe më shpejt e makina s'po
më hiqej nga sytë. Vraponim ne dy vëllezërit, tash-
më në të njëjtën rrugë.

AI U KTHYE PËRSËRI

— Në çdo rrugë të njëjtën pyetje, — i tha Titi agjentes. — A ke bileta, a ke bileta? Kam, një bllok të tërë kam!

— Mos u rrëmbe, — foli ajo e zgjati fletudhëtimin.

Titi mori fletudhëtimin, hipi udhëtarin që i kish-te premtuar dhe nisi makinën. Udhëtari nxori një pesëlekësh dhe ia zgjati.

— Ka kohë, — i tha Titi e vuri një biletë në cepin e buzëve. Me dorën tjetër takoi çelësin e fshe-sës së xhamit. Pikat e shiut qëllonin ritmikiisht ka-binën, po dalngadalë kjo zhurmë u bë monotone dhe ndoshta ky qe shkaku që e detyroi udhëtarin të dremiste pa bërë ende kilometrat e parë. Titi ktheu kokën nga ai dhe qeshi me qetësinë e tij. I pëlqeu t'i fliste, sepse kohës me shi, e sidomos në udhëtim, i shkon bashkëbisedimi. Por udhëtari s'të jepej për i tillë e Titi e kuptoi, falë profesionit për këtë. Shtoi shpejtësinë e, kur doli sipër në qafë, pa nga prapa se mos dukej Qemali, po nuk pa gjë, madje as zhurmë makine nuk ndjeu. «Do të jetë vonuar në ngarkesë», mendoi. I ra dy-tri herë borisë po s'mori përgjigje. Atëherë ndërroi marshin e çau mes shiut. Diku frenoi.

— Ç'është?! — pyeti i habitur udhëtari, por u qetësua shpejt. Pranë tyre kishte qëndruar kontrolli rrugor.

— Edhe sot s'i është ndenjtur në një vend, — belbëzoi Titi e hoqi biletën nga cepi i buzëve. U mat t'ia jepte udhëtarit, po s'pati kohë. Kontrolli hapi derën dhe pyeti:

— Ç'kemi? Lagështi e madhe, — vazhdoi ai. — Kujdes, kujdes, vëlla. Qenke vetëm me sa duket.

— Është Qemali nga prapa, — tha Titi.

— Mirë, — shtoi kontrolli, — në të tatëpjetën ndizi dritat, — e u bë gati të zbriste. — Ë, po ai shoku, e ka biletën?

Ndërkohë udhëtari bëri prapa.

— Bjere, — tha kontrolli.

Titi e pa vëngër udhëtarin. Ngurroi një çast, pastaj i zgjati biletën, që pa dashje e kishte zhubravitur me grushtin e dorës së djathtë.

Kontrolli ngrysi vetullat e foli:

— E ke ti, apo udhëtari? Pse s'ia paske dhënë?

— Ka kohë, — foli Titi, — derisa të zbresim. Ka kohë.

— S'kam ndër mend të të lexoj rregulloren, — tha prerë kontrolli, — por po të them se e ke shkelur.

— Ç'shkelje shikon këtu? — tha Titi duke parë drejt.

Kontrolli i hodhi sytë dhe ai qëndrim i shoferit po ia humbiste durimin. Megjithatë foli qetë.

— Çdo ditë nuk do të flasim për të njëjtat gjëra. Këtu ka shkelje dhe me të dyja këmbët bile...

— Ja që harrova, s'ia dhashë, — e ndërpreu Titi.

— E pamundur, — tha kontrolli. — Kjo do të thotë t'i shmangesh përgjegjesisë. Të lutem, patentën!

U ndie një kërcitje dhëmbësh.
Kontrolli i dha kokës lart dhe hodhi sytë mbi shoferin.

— Deshe patentën, — foli Titi, po këtë radhë me zë më të lart. — Merre, ja ku e ke.

— Më ngadalë, — foli qetë kontrolli, — pranoje gabimin, bile prano që ky rast duhet ndëshkuar më shumë, po bashkë s'jemi takuar për gjëra të tilla dhe kësaj radhe po mjaftohem...

Titi s'dëgjoi, ose s'deshi të dëgjonte më. Sytë dhe mendjen i kishte përqëndruar te dora e kontrollit, që po i hiqte latën e parë. Tëmthas i rrahën fort, duart i shtrëngoi pas timonit. Kontrolli përshëndeti dhe u largua.

Ndezi makinën. Një kërcitje e fortë erdhi nga kamjoja. Diç shau nëpër buzë. U dha shpatullave përpara e makina u nis.

— Në mes shiut ka dalë, — foli Titi, — si ta ketë veturë atë të uruar motor!

Peshoi mbi timon e ndërkohë u kthye nga udhëtari që ishte gati të dremiste. «Edhe ky, njeri më vete», — mendoi Titi, — si t'i ketë futur fjalët në fund të ndonjë pusi». U nxeh me të.

— Pse s'më kujtove të të prisja biletën?... — deshi të shfrynte Titi, ndonëse i kujtohej fare mirë që udhëtari i kishte zgjatur pesëlekëshin. Udhëtari s'foli, dukej flinte e Titit i pëlqeu kjo.

«U bë për të mos marrë njeri rrugës», — mendoi. Ndezi dritat. E tatëpjeta po mbaronte e rrëzë luginës dukej Shkumbini, që ishte fryrë shumë atë ditë. Një bubullimë brodhi nëpër qiell, u duk sikur u zgjat deri mbi asfalt e u hodh tej në grykë. Zhurma e fortë e bëri udhëtarin të hidhej përpjetë. Pastaj zhurma u pasua nga një e dytë, bile më e madhe. Pikat e

shiut u dendësuan. Motori i Skodës shfryu dy-tri herë, thuajse ishte i kënaqur nga udhëtimi i porsanisur në fushore. Tutje, nën një rrap ishte futur një plak. Me të parë Skodën, ai bëri deri në mes të rrugës. Ngriti dorën, po Titi bëri sikur s'e pa. Nuk ndaloi. Në pasqyrë pa plakun që qëndronte ende në mes të shiut duke lëvizur njërën dorë drejt makinës, ndërsa me tjetrën sikur shtypte fundin e barkut nga ana e djathtë.

«Më shau», — mendoj Titi. — «Më shave, o plak! O më shave, o më mallëkove. Po ç'faj kam unë. As ti s'ke faj, o plak, ku i dihet ç'hall ke! Atij thuaji, atij që iku me motor lart, ose prite të të vijë e të të marrë ai, se të merr patentën ai, o plak. Po, po, ta merr».

Duart që kishin shtrënguar timonin i dhembën dhe ai i largoi dhe filloi t'i fërkonte mbas gjunjëve. Mori patentën që kishte para dhe e përplasi mbi kroskot.

— Kushedi ç'hall ka tjetri, — tha e u kthye nga udhëtari që kishte mbyllur sytë, kishte zgjatur buzët para dhe shfrynte. Ky lloj gjumi i prishi nervat shoferit. Ndërroi marshin me shpejtësi. Ecte krah Shkumbinit, si të ishte vënë në garë me të.

Ishte afër hyrjes së qytetit, kur dëgjoi një bori. Heshti. Boria u dëgjua përsëri.

— Qemali! — belbëzoi Titi.

Boria erdhi më e zgjatur. Zgjati kokën në dritare, po Qemali i fluturoi përpara syve.

— Ç't'i ketë ndodhur, ç'është kjo urgjencë? — tha Titi me zë.

Shtoi shpejtësinë e, kur doli në kthesë, pa vetëm stopat e kuq të makinës së Qemalit që humbën po atë çast nga sytë.

Me të vajtur në park, zbriti udhëtarin dhe pyeti për Qemalin. I thanë se Qemali çoi në spital një plak.

«Plak!» — ishte habitur Titi. «Ç'ishte ky?» — E mendja i shkoi te plaku që kishte lënë në mes të shiut. «Po ç'ne, plaku nuk ishte i sëmurë». — Kjo e qetësoi dhe hyri në bufe.

Pas pak aty erdhi edhe Qemali e prapa tij usta Emini.

— Qemal! — thirri Titi e diç donte t'i fliste, po fytyrës së Qemalit i kishte rënë një hije e rëndë. Qemali diçka porositi.

— Merre këtë gotë nga unë, — i tha Titi e zgjati dorën.

Qemali ia nguli sytë për një çast.

— Të falemdir, — i tha. — Këtë mirësi të kishe treguar dhe ndaj plakut.

Titi tërhoqi dorën prapa. Fjalët e Qemalit e qëluan në ballë, po s'e dha veten.

— Ç'hyn plaku këtu? Ç'do të thuash?

— Em, — bëri Qemali.

— Fol, — thirri Titi. — Të pyeta, ç'hyn plaku?

— Kush hyn, — tha Qemali, — apo ajo heqja e latës? Dhe në fund të fundit mos u nxeh, s'mjaftoi që ishe gabim po dhe ishe grindur me kontrollin.

Titi thithi fort cigaren. Fjalët e Qemalit, si majë shtize, po i hynin thellë në trup.

— Titi, dëgjo, mor bir, — foli shtruar ustai. — Plakun nuk duhej ta kishe lënë në mes të shiut, kjo s'na nderon ne. E përse...

— S'kisha ndër mend ta lija patentën rrugëve, — e ndërpreu Titi dhe u mbështet më fort në banak.

— Patentën? Vetë e ke në dorë, — tha Qemali

duke ngritur vetullën e djathtë lart, shenjë nervozizmi kjo.

— I paske këshillat në majë të gjuhës, — tha Titi.

Qemalit tëmthat i rrahën fort dhe pa nga ustai. Ai seç bëri një shenjë me kokë e i foli Titit:

— Pse rrëmbehesh, dëgjo, përtypi njëherë ato që të thotë tjetri.

— Nuk e dëgjon ç'thotë?! — foli përsëri me inat Titi.

Qemali mori një pako të mbështjellë dhe pasi përshëndeti u bë gati të dilte.

— Atje në spital, — i tha ustai Titit, kur Qemali kishte mbyllur derën pas tij, — të takon ty të vesh. Dhe zbutë gjuhën, se ia bëre borxh Qemalit sot.

— Jo, — tha Titi, — sot s'ishte në terezi. Mos ndoshta kërkon të përfitojë nga ajo që unë gjithnjë e kam respektuar si mësuesin tim. Ndoshta i është rritur mendja.

— S'kam dëgjuar që të thonë mendjemadh për të. Për të zotin, po. — tha ustai e vazhdoi: — Unë ju kam të dy njësoj, mor bir. Ti je i ri. Dje hyre në punë dhe s'të ka hije të sillesh kështu.

Pastaj ustanë e thirrën nga fundi i lokalit e ai u largua duke i rrahur shpatullat Titit:

— Merre më shtruar, mor bir.

Titi ktheu gotën që kishte para, porositi dhe një tjetër, e ktheu edhe atë. Po në çast u shtang, shikimi i bufetierit ia acaroi nervat.

— Ç'm'i ngul sytë ashtu? — tha Titi. — E... apo ke frikë se s'të paguaj dot? Na, na mbushe mendjen! — Futi dorën në xhep dhe nxori një shuk lekësh të zhubravitur që i hodhi mbi banak. Merri, merri!

Bufetierit iu duk sikur u përplas fort pas ba-

nakut dhe dhembja ia mbushi tërë trupin. Bufetieri ishte një burrë faqekuq, i shkurtër, që shkonte e vinte tërë ditën prapa banakut, fjalëpak dhe i ndershëm. Mezi e mblodhi veten e foli:

— S'kam nevojë për to, — tha bufetieri. — S'kam nevojë. Unë marr aq sa më takon. Marr atë që më takon. Bëj shok ndonjë tjetër e jo mua.

— Pse, unë si qenkam, — tha Titi — mos kam pirë e s'të kam paguar? Ë, fol, pse s'flet?

Bufetieri u hoq mënjanë dhe vazhdoi punën e tij. Ndërkohë ustai, që ishte nga fundi i lokalit, kur dëgjoi të bërtiturat e Titit, u çua e erdhi pranë banakut.

— Ç'është kështu me ty! — i tha. — E paske zënë me llafe sot!

— Nuk e dëgjove ç'më tha?

— Po të gabosh, — tha ustai duke tundur kokën, — po të gabosh...

Titi i dha dorës lart, që donte të thoshte: «mjaft, mjaft». Dhe ustait i mbetën fjalët. Pastaj Titi lëvizi shpejt, rrëmbeu lekët mbi banak, i ngjeshi ata në xhep e po dilte. Bufetieri e thirri dhe i bëri shenjë nga gota që ishte porositur për Qemalin, dhe që ishte e paprekur.

«S'e pive, Qemal?» — mendoi me kokën të rëndë Titi. — «Nuk e pive? S'të dhashë helm, Qemal, konjak të dhashë. Të gjitha gjërat ti sot i bëre lëmsh».

Titi doli jashtë, ku era e ftohtë dhe pikat e shiut i rrahën trupin. Koka i dhembte. Cigaren s'po e shijonte, e hodhi dhe shpejtoi hapat. S'i kishte qëlluar të kthehej vetëm në shtëpi. «Dhe ja, ardhka një ditë dhe u ndakan rrugët. Bukur, Qemal, bukur. Po të kishe gjë me mua, më mirë të ma thoshe hapur e jo të hidheshe kështu degë më degë; jo plaku, jo pa-

tenta. Pse, unë e lashë plakun, apo ai që më hoqi latën?»

Në çast sikur e preu fillin e mendimit, dora e djathtë i kishte shtrënguar fort patentën. Gishtërinjtë i dhembën. «Lata fluturoi, tha, e pse, për atë dreq udhëtari, që me siguri do të jetë diku duke dremitur. Por edhe ai ma dha atë djall pesëlekësh». Heshti. Dhe për herë të parë gjatë ditës i erdhi inat me veten. Pikat e shiut u bënë më të shpeshta. Ngriti jakën e xhaketës e nxitoi. Kur hyri në shtëpi, e ëma u çudit. Titi ishte lagur.

— Si qenke bërë kështu, ujë?! — i tha ajo.

Titi ndjeu dorën topolake të s'ëmës mbi shpatulla.

— Ujë, mor bir, ujë qenke bërë. Hyr ngrohu pak në kuzhinë.

Ai s'deshi të hynte. Donte të shtrihej, po dora e butë e s'ëmës e shtyu drejt derës. Përshëndeti babanë që ishte shtrirë e lexonte një libër.

— Ç'shi ra sot, — tha babai. — A ra andej lart?

— E pa marrë përgjigje, vazhdoi: — Kur do ta bëjmë revanshin, mbrëmë kot fitove. Akoma nuk mund të them se të kam një nxënës të denjë.

Pastaj babai qeshi: edhe mamaja vuri buzën në gaz, po Titi nuk i pasoi ata. Babai ngriti kokën. Syzet i kishin qëndruar majë hundës. Pa i habitur nga e shoqja. Edhe ajo e vështroi atë.

— Hajde, çohu, — thirri babai, — jam gati, — dhe mori kutinë e shahut.

Titi prapë heshtte.

— Prit, mor burrë, të thahet, — tha mamaja.

— Ahu, djalë i ri ai, kur isha unë si ai...

— Fillove ti, — e ndërpreu mamaja. Qeshi dhe iu drejtua Titit: — Hiqe xhaketën, se e thaj unë.

Hajde, mos ia prish. Munde edhe sot, që t'i mbushet mendja, — dhe filloi t'i hiqte xhakëtën.

— E heq vetë, — tha Titi nëpër buzë.

— Hiqe pra, — foli pak sert babai. Sjellja e të birit po e çudiste.

Titi me ngathësi po zbraste xhepat. Hodhi mbi tryezë, ashtu krejt pa e pasur mendjen, lekët e mbledhur shuk e bashkë me to edhe patentën. U shtang. Vështroi lekët që e kishin rrethuar dhe pastaj sytë çanë drejt patentës. E pa për disa sekonda. E ndjeu se muskujt po i shkreheshin dhe u zgjat ta merrte. S'mund t'i fshihte më.

— Po tërë këta ç'i ke, ku i more, — tha i ati që, sikur të parandjente diçka jo të mirë, u ngrys në fytyrë.

Titi, si të mos kishte dëgjuar, vazhdoi të vishte pizhamet.

— Po të pyes, ç'janë këto? — dhe me duar i shtyu. — Për këto e more patentën? — Babai kishte marrë në dorë patentën dhe e përplasi. Sytë e Titit të frikësuar u zmadhuan, kur patenta që u përplas mbi tryezë u hap duke zbuluar të fshehtë.

— Em, të paskan hequr latën. Na paske nderuar! Pse ta kanë marrë, për këto? — foli babai, krejt i nxirë në fytyrë.

Titi s'po përgjigjej. Dora e djathtë mbështetur pas kokës kishte shtrënguar një shuk flokësh e mbahej pas tyre.

— Titi, — foli mamaja kur pa dorën e të shoqit që dridhej.

— S'ka lidhje me lekët, kot, fare kot ma hoqën, — foli Titi e i dha dorës poshtë.

— Kot! Si kot? Atëherë le të ta hiqte dje, — foli babai e vuri dorën te supi i së shoqes, mbasi

e dinte se ajo nuk i duronte dot tronditjet, — po ta hoqi sot, — vazhdoi babai. — Se sot ti i ke marrë, i ke..., — e me dorën tjetër shtyu lekët që qenë mbi tryezë.

— Si i kam marrë? — foli me zë të lartë Titi. — C'do të thuash: i ke marrë, i ke marrë! Mos i grabita? Ë? Mos i grabita? — E u çua më këmbë dhe foli: — Atëherë unë, unë..., — fjalët e tjera iu ngatërruan nëpër gojë. Rrëmbeu xhaketën e doli.

Mamaja siç ishte, u ul, thujse ia shkurttoi njeri këmbët dhe foli ngadalë:

— I fole rëndë, mor burrë, i fole rëndë, është i ri e ka nevojë të edukohet.

— Jo po është bebe, — tha me zë të lartë babai. — I ka munguar gjë, që u detyrua të marrë lekë në këtë mënyrë?

Titi, që po zbriste shkallët, i dëgjoi fjalët e të atit. Tëmthas i rrahën dhe dhëmbët iu shtrënguan. U kthye rrëmbimthi e bëri drejt derës, peshoi mbi dorëzë, po nuk e hapi atë. Nga dhoma erdhi zëri i babait:

— Dëgjo, moj grua, dëgjo. Ke dy vjet që je e sëmurë, sa herë të kemi çuar në spital, sa herë të ka ardhur mjeku këtu, a mban mend të kemi paguar ndonjëherë? S'kemi pse të paguajmë, shteti i paguan rrogën secilit, siç më jep mua, siç i jep dhe Titit tonë.

Ndërkohë Titi që bërë gati të dilte, po ndërroi mendje, lëshoi dorezën.

Një zë i brendshëm i thoshte: «Sot të gjithë të shanë, të kritikuan, kjo tregon se s'je në rregull, pran-daj ndërro sa s'është vonë».

I vinte zor të hynte në kuzhinë, ndaj pa ngrënë darkë vajti në dhomën e vet. Ndihej i lodhur, i rras-kapur, po kokën e kishte më të lehtësuar, s'i buçiste ashtu si pak më parë.

TANKU DOLI NË KODËR

Ishte java e tretë e stërvitjes në terren me tank. Dy javët e para stërvitjen e kishin bërë ditën. Këtë javë, ndoshta dhe tjetrën, kjo varej se si do të mbante koha, do të stërviteshin natën. Ata të tre, që pritnin radhën, ishin mbështetur pranë një gëmushë. Bënte pak ftohtë e sidomos tani, kur një erë e fortë shpërndau retë e kudo filloi të zbardhte.

— Zbardhi! — tha Ramizi dhe një e rrëqethur i përshkoi trupin.

— Për herë të parë e gdhin? — e pyeti Sadiku, ndihmësi i instruktorit, e pastaj vazhdoi: — Ushtari e përshëndet i pari diellin dhe jo dielli ushtarin, ky është privilegji ynë, vëlla!

— Bile, po nuk urdhëroi ushtari, s'lind dielli, — foli i treti. Ky ishte Meti, një ushtar i ri, ardhur në një kohë me Ramizin. Dy të tjerëve s'u pëlqeu kjo ndërhyrje, ndonëse heshtën. Sipër në kodër u duk tanku. Ai bëri dy-tri ulje-ngritje e hyri në një rrugë të drejtë. Me sa dukej, e ngiste vetë instruktori, manovrimet të tilla në shpejtësi e sipër vetëm ai mund të bënte.

Nuk vonoi shumë dhe tanku ndaloi afër tyre.

Nga vendi i shoferit kërceu instruktori, një djalë

i shkurtër, me gjoks të zhvilluar. Ai shtriu krahët, bëri nja dy lëvizje prej atleti dhe thirri:

— Radhën, kush e ka radhën?

— Unë, shoku instruktur, — tha Ramizi dhe u nis drejt tankut.

— Do të vazhdosh më, shoku instruktur? — pyeti Sadiku. — Tani pothuajse u bë ditë.

— Edhe këtë radhë, Sadik, mos u mërzit, se mbrëmë e filluam vonë! Sot na e bëj më shpejt gati tankun, që ta shfrytëzojmë mirë natën.

— Siurdhëron, shoku instruktur, — tha Sadiku dhe diç po kontrollonte te rrota drejtuese.

Në këtë kohë Ramizi, që kishte zënë vendin e shoferit, ndezi motorin dhe gati sa nuk shkeli frek-sionin. Sadiku u hodh rrëmbimthi, duke shpëtuar për mrekulli.

— Dil jashtë! — bërtiti instruktori. — Kush të urdhëroi ta ndezësh?

Ramizi e humbi. Zbriti nga tanku i zverdhur.

— Të kam thënë unë, të kam thënë që ditën e parë, — foli Meti.

— Çfarë i ke thënë? — për çudi kësaj radhe instruktori foli i qetë.

— Që ditën e parë i kam thënë, shoku instruktur. S'bëhet shofer kushdo! Ai s'dallon dot grason nga marmelata, — dhe një e qeshur iu var ndër buzë Metit. — Duhet të kesh punuar me hekura dhe jo në arë.

.Në çast Meti zuri vendin e shoferit.

Instrukturit një damar ia ndau ballin në mes.

— Të të vijë zor, mendjemadh, — foli instruktori.

Sadiku kishte ulur kokën. Ramizi me një shikim

shpues ndiqte lëvizjet e Metit. Mbas pak u largua. Ndaloi e u ul.

Se pse iu kujtua ai mëngjes i lagur dhe i ftohtë nëntori, kur u nis ushtar. Pasi kishin bërë një pjesë të mirë të rrugës, i ati i kishte thënë:

«— Të kthehet baba, Ramiz? Ti tani je goxha djalë.

— Mirë, — i ishte përgjigjur Ramizi.

— Hajt, nga pushka në top vafsh.

Ramizi kishte qeshur.

— Dëgjo, — i kishte thënë i ati, hap sytë, se atje mësohet. Po t'u dha ndoresh, mëso ndonjë zanat.

Ramizi kishte miratuar me kokë dhe prapë kishte qeshur».

Po atë mbasdite, vonë, një Zis ushtarak me rreth 20 djem, shkante drejt veriut. Diku Zisi la asfaltin dhe mori drejt një lugine. Pikërisht aty ku mori kthesën, një ushtar që ecte hipur mbi një karrocë, pyeti:

— Nga jeni çuna?

— Nga E., — u përgjigjën disa zëra.

— Hajde, tankistët e ardhshëm, — tha ushtari dhe gjithë qejf ngau karrocën.

— Tankistë! — u dëgjuan një grup zërash dhe pastaj shpërtheu një urra e fortë.

— Dëgjoni, djema, dëgjoni.

Ky që po thërriste ishte Meti.

— Unë për vete e kam të sigurt që do të bëhem shofer tanku, dhe ja, që tani po e zgjedh atë që do të më mbajë predhat. — Dhe në çast u ra shpatullave të Ramizit. — Ky buçkoja në arë ka punuar, ç'mund të bëjë tjetër!

Dikush qeshi. Ramizi mundohej ta hiqte dorën e

Metit nga supi. Iu duk sikur mbi sup i qëndronte një shkëmb dhe donte ta largonte sa më parë...

— O Ramiz! — u dëgjua zëri i Sadikut.

Ramizi e dëgjoi, po s'donte të largohej nga ai kujtim i ditës së parë.

— O Ramiz! — u dëgjua përsëri zëri.

«— Ëm, — bëri Ramizi. — Edhe sot e gjeti rastin dhe ma përmendi. Ka punuar në arë, — thotë».

— U mërzite më duket, — foli Sadiku që i qe afruar.

— Më fal. Nuk e di por e humba. Po Meti më fyeu. Është e dyta herë që ma bën borxh!

— Ti mos u prek. Meti e ka gabim. Kujton ai se vetëm ata që kanë punuar nëpër ofiçina mund ta mësojnë tankun, po ti dëgjo vëllanë. Unë s'pata punuar ndonjëherë mekanik. Mësues kam qenë. Tanku, nuk e di, po më emociononte shumë. Ti ndoshta e ke ndier. S'ka më i fortë se emocioni i armës; zaten një armë gjahu kap dhe ndien emocione e jo më të vësh në lëvizje atë kolos, të shkundësh nga gjumi «mbretin e tokës». Po çdo gjë kalon, ai të bëhet shok, të duket sikur ajo fole metali është bërë tamam për ty. Më dëgjo mua. Po e deshe tankun, edhe ai të do dhe shpejt do të bëheni miq.

— As ti s'paske pasur të bësh me hekura?

— Jo vetëm unë, por edhe shumë të tjerë kështu kanë qenë, — tha Sadiku.

Ramizi e ndjeu veten të lehtësuar dhe diçka donte të shtonte. po Sadiku që mendoi se ai kishte ende dyshim, shtoi:

— Hiq dorë, largoje atë mendje. Ti do të bëhesh tankist!

— Diçka tjetër desha të të thosha, — e ndërpreu Ramizi.

— Hë?

— Kam qejf të mësoj ndonjë zanat. Edhe baba këtë dëshirë kishte, po kur s'do, s'do. Nejse. Ëm, — bëri, — kooperativa s'ka tanke.

Sadiku qeshi dhe i hodhi dorën në qafë.

— Më kënaqe, për nder, po traktorist, s'do kooperativa juaj?

— Do, — tha Ramizi.

— Atëherë tanku dhe traktori të një familjeje janë. Njëri e punon tokën, tjetri e mbron. Vëllai im për tankist ka mbaruar e pastaj ndoqi një kurs për traktorist. Sot është traktorist. Babait tënd duhet t'i pëlqejë ky zanat.

— I pëlqen! — tha shpejt Ramizi, sikur të hiqte ndonjë barrë të rëndë.

— Çohu, tankist dhe traktorist i ardhshëm, — foli duke qeshur Sadiku.

Mbasi bënë një pjesë rruge bashkë, Sadiku u nda. Ramizi ecte i vetëm për në repart. Te porta ndeshi me instruktorin, e përshëndeti. Instruktori e nderoi dhe u largua. Ramizi diçka ndjeu. Iu duk sikur instruktori qëndronte ende mbi tank dhe thërriste: «Dil jashtë. Kush të urdhëroi ta ndezësh? Dil!» Pastaj iu kujtua Meti. «Ç'njeri, — tha më vete. Instruktori ia bëri paq: «mendjemadh» i tha. Sikur edhe me shqelma të më kishte nxjerrë nga tanku, nuk do më mbetej hatri. Instruktori s'pushon gjithë natën, ndërsa unë, që as gjysmën e tij s'bëj, vjen një çast dhe e humbas, e bëj të pabërën». Me këto mendime hyri në repart.

Ishte nata e fundit e javës së tretë. Tri netët e fundit stërvitjen e drejtoi Sadiku, mbasi instruktori kryesonte një komision. Atë natë u kthyen më shpejt. Sadiku futi tankun në park. Mbas pak nxori një kovë me naftë dhe nja dy leva.

— Djema, — thirri ai, — sonte është e shtunë, fund jave dhe tanku ka natën e pastrimit. Si thoni ju?

— Si urdhëron, shoku instruktor, — foli dhe qeshi Ramizi.

— Më bëre instruktor, nejse, po e pranoj. Ti, Met, dil nga krahu i djathtë, ti, Ramiz...

Sadikut i mbeti fjala në gojë. Meti po lar-gohej.

— Ku shkon? — tha Sadiku.

— Jam sëmurë.

Dy të tjerët panë sy më sy njëri-tjetrin.

— Jam sëmurë, bën ftohtë, — foli duke ngatërruar fjalët Meti.

— Je sëmurë, apo ke ftohtë?

— Të dyja, — tha Meti dhe iku.

— Lëre, Sadik, — ndërhyri Ramizi, — këto ditë që ka munguar instruktori, ky me bishta i ka bërë punët.

— S'bën, Ramiz. S'kalohen tre vjet kështu, pa le që kjo sjellje të bëhet vazhde dhe në jetë.

Megjithatë të dy ia nisën pastrimit. Vonë mbaruan. Ndihehin të lodhur, por ishin të kënaqur. «Mbreti i tokës» do ta kalonte ditën e pushimit i pastër.

Të hënën, herët në mëngjes, kishin nxjerrë tankun dhe të tre po pritnin instruktorin. Shiu, që s'kish-te pushuar tërë natën, tani në mëngjes u rrallua de-

risa pushoi plotësisht. Toka ishte bërë baltë e llucë. Mbas pak erdhi instruktori. Ai i përshëndeti dhe dukej në qejf. Sa u afrua, komandoi:

— Dëgjoni, ti Sadik, do të vish me mua, ndërsa ti, Ramiz, merr tankun dhe të dy me Metin na pritni te vishka.

Ata të dy u larguan. Meti, sikur të kishin urdhëruar atë dhe jo Ramizin, kërceu te vendi i shoferit. Ramizi vështroi vëngër, po s'e zgjati. Njëherë u mat t'i thoshte: «dil, se instruktori më urdhëroi mua», por e la.

Meti i ra motorinos, ajo u ndez. Rrëmbimthi shkeli freksionin. Tanku u trondit dhe si me kërcim u hodh para. Ramizi u tremb dhe ia mbërtheu shtë Metit. Ky, kushedi ç'i thoshte mendja, filloi të qeshte. Ramizi u nervozua. Motori hera-herës nxirrte nga një tingull jo të zakonitë. Pastaj tanku mori djathtas.

— Prije majtas, — foli Ramizi. — Po të hysh këtu, toka është e lagur e nuk do ta ngjitësh dot në kodër.

— Po të jesh ti, po, — u përgjigj Meti.

Shiu krisi me rrëmbim. Rrëke të vogla filluan të formoheshin.

— Ktheje, — bërtiti Ramizi. — Do të mbetesh në llucë e s'dalim dot.

Meti, si për inat, mbylli kapakun e shoferit e drejtonte me periskop.

Ramizi qëndronte lart. Shiu e bëri qull.

— Ktheu, — bërtiste dhe i binte kapakut të shoferit.

Meti s'donte t'ia dinte; kur filloi të ngjiste kodrën, motori zhurmoi fort, po s'tërhoqi. Meti i dha edhe më tepër gaz, po tanku u zbraps duke hapur

gropa, të cilat mbusheshin me ujë. Një masë e tërë balte u përplas pas zinxhirëve.

«Mbeti!» — tha Ramizi dhe kërceu në ujë. U mundua të fshinte kokën e lagur, por qe lagur aq shumë, sa rrëke të vogla uji i zbritnin drejt fytyrës. S'dinte ç'të bënte. Rrëmbeu lopatën dhe mundohej të hapte vijë kulluese.

— Zbrit! Ç'bën aty? — i bërtiti Metit, që rrinte sipër, mbi tank.

— Ka ujë, — tha ai, — lagem.

— Si? Lagesh? — dhe bëri drejt tankut Ramizi.

Me të shpejtë dhe duke rrëshqitur vende-vende, po zbritnin kodrën instruktori me Sadikun.

— S'ta pata borxh, Ramiz! As unë, as tanku, — foli instruktori dhe në kohë fshinte fytyrën që i kullonte ujë. — S'ta pata borxh!

Ramizit i ra lopata nga dora, po shikimin s'ia ndau Metit.

— Si të urdhërova? S'të dija të padisiplinuar! Turp të të vijë! Ç'do tanku në kënetë?

Ramizi donte të fliste, po ngurronte. Ai donte që Meti ta tregonte vetë se si kishte ndodhur. Meti heshtte me kokën ulur.

— Pse? — tha Sadiku duke i hedhur një shikim qortues Ramizit.

— S'e bëra unë, Meti e bëri, — foli më në fund Ramizi.

— Ashtu? — i tha instruktori Metit. — Po, pa tjetër ti do ta bëje. Po dëgjo: këtë muaj ti s'merr patentë, po ta them copë. Po deshi le të flasë dhe Sadiku, por unë e di se edhe ai kështu mendon. Është e mira të jesh ushtar e pastaj i zoti për t'u bërë shofer tanku. Të urdhëroj të shkosh në kompani! Kur

ta shoh se je bërë ushtar i mirë, do të të marr përsëri,
që të bëhesh dhe një tankist po aq i mirë.

Meti uli kokën dhe s'po lëvizte nga vendi.

— Të urdhërova, — tha instruktori.

Ata të tre që mbetën hapën dy vija kulluese.
U dukën më në fund zinxhirët.

— Merre, merre, ti do ta çosh sipër në kodër,
— i tha instruktori Ramizit.

Ramizi ngurroi.

— Nise, — përsëriti instruktori.

Në kohë u ndez motori. Ramizi shkeli freksionin,
tanku mori të përpjetën.

— Vazhdo. — tha instruktori. — Me këtë ritëm
çoje deri sipër.

K E T R I

Me Petritin u takova në tren. Kishim mbi tre vjet që s'ishim parë.

— Ku je, Besnik vëllai, ku je, ç'vapor të nxori?
— thirri ai nga kreu i vagonit e bëri drejt meje.

Dhe një numër i pambaruar pyetjesh vërshoi. Kështu ndodh gjithmonë kur takohen dy shokë të vjetër ushtrie. E fillojnë nga dita e parë e njohjes e me radhë deri në ditën e fundit. Më shumë pyetja unë, mbasi qeshë larguar një muaj para tyre dhe që prej asaj kohe s'kisha takuar asnjë shok. Nga biseda mora vesh se dikush ishte martuar e dikush akoma beqar, njëri kishte shkuar në universitet e tjetri ishte rritur në përgjegjësi; ç'ta zgjatim, të gjithë si kokrra e mollës ishin. Vetëm njëri nga miqtë na mungonte, Ketri. Ah, sa u mërzita kur mora vesh vrasjen e tij. «Ketri! Çudi, ç'qen, Besnik! Sa nuk i shkonte ai emër atij. Ç'qe ajo gojë që e pagëzoi ashtu, apo ndoshta s'pati faj, se lëvizjet e shkathëta të tij s'kishe me kë tjetër t'i krahasoje, po trimërinë, Besnik vëllai, me kë t'ia krahasoje?» Me sa pasion fliste për Ketrin Petriti. Tërë ditët e ushtrisë ata të dy s'ishin ndarë.

Vetullat e Petritit u mblodhën dhe balli iu rrudh.

— Nuk do ta harroj kurrë atë mik. Ndonjëherë,

kur mendoj se ai s'është më, se si më vjen. Nuk më hiqen nga mendja ata sytë depërtues, ajo ecja krenare dhe ai trupi i bëshëm e me atë qime të murme.

Atë ditë ndenja më shumë se çdo ditë tjetër me të. Ti e mban mend, se ne u lidhëm shumë bashkë. Që ta pata fjalën, — vazhdoi Petriti, — ndenjëm gjithë ditën bashkë, si ta dinim se nuk do të rrinim më kurrë.

Kur zbardhi, shtrëngata ra pak, megjithatë retë, si të kishin marrë vrapin, shtynin njëra-tjetrën drejt jugut.

Nga pylli vinin ca kërcitje të fuqishme, të dukej sikur zemra e pishave po shpërthente që të çante atë gjumë të akullt. Natyra përreth nuk duronte në asnjë mënyrë që ajo gjendje të vazhdonte më; pranvera duhej të kishte ardhur. Pse të vonohej?

Vajta të nxirrja Ketrin. Le ta shikonte edhe ai këtë agim krejt ndryshe nga të parat, ku era kishte diçka të veçantë, vinte më e lehtë dhe më e ngrohtë. Ketri që më kishte ndier, filloi të hungronte e t'i binte derës me ato putrat e tija të shëndosha. Kur hapa derën, ai m'u hodh në sup, më ra dy-tri herë me kokë si për të më thënë «mirëmëngjes». Desha të bëja një shaka, çunat ishin aty përreth, e mbërtheva për këmbësh dhe e përplasa përdhe. Qeshëm. Ketri ra, po më së fundi u ngrit, e si të mos i kishte ndodhur gjë u shtri sa gjatë-gjërë. Unazat e muskujve i valëzuan nëpër trup dhe sytë i shndritën. E ndjeva se qeni u inatos, instinkti i vetëmbrojtjes, po kundër meje e kishte të vështirë të ndërmerre një hap të tillë. Ti e mban mend, se ai s'e duronte të qeshurën e sidomos kur ajo kishte të bënte me të, na vështroi të gjithë, pastaj shikimin e nguli mbi

mua, si të donte të më thoshte: «C'të të bëj, ma punove». E kuptova se sedra e tij ishte prekur, krenaria e tij ishte cenuar, ndaj ua bëra me dorë djemve që të largoheshin.

— Shkojmë, — i thirra, — hajde.

Ai s'po lëvizte.

— Ketër, — thirra, po me një ton tjetër, — para! Atëherë lëvizi, uli sytë dhe rëndë-rëndë më doli përpara. U varëm tatëpjetë pyllit. Këtej era nuk ndihej, po zhurma e përplasjeve të degëve vinte më e fuqishme.

Bëra disa ushtrime me të dhe ai i kryente me seriozitetin e tij të zakonshëm, po në kohët e pushimeve, të çlodhjeve, ai s'ishte si ditët e tjera: shkonte pushonte mënjane dhe herë-herë më shikonte mua.

«Djali ta marrë, — thashë, — dhe ai si të ketë sedër». Iu afrova dhe iu hodha, e kapa për qafe dhe e mbështeta trupin tim pas trupit të tij, ai po forcohej, unazat e muskujve po i mblidheshin dhe qimja iu bë si halë pishe. Dësh e rrëzova, por ai i dha fuqishëm trupit e, sa të hapje e të mbyllje sytë, u gjend mbi kurrizin tim. Më rrotulloi dy-tri herë dhe mua m'u morën këmbët e rashë përdhe. Këtri filloi të kërciste dhëmbët, sikur të bëhej gati të më kafshonte, por unë e dija se me mua ai s'e bënte këtë. Hungrima e tij e sertë dhe qimja e murrme e ngritur përpjetë shprehnin qartë se ai e ndiente veten të fyer nga unë.

U ndamë e një kohë vështruam njëri-tjetrin.

«E more hakun», — mendoja unë.

«Vetë ma bëre borxh», — sikur më thoshin sytë e tij.

Kur e pa se vendosi shenjën e barazimit, u shtri përtokë. Unë iu afrova dhe nisa ta përkëdhelja, ai

ndihej i kënaqur, u ngroh si t'i kishin rënë të gjitha rrezet e diellit mbi trupin e tij.

Rrugën e kthimit e bëmë gjithë qejf.

«Ej, Ketër, or mendjemadh» — i thirri një nga çunat, kur hymë në oborrin e postës.

Ketri grumbulloi forcat e në çast u hodh para, ia ngjeshi me kokë ushtarit e pastaj u kthye prapa e tërë seriozitet hyri në vendin e tij.

Atë pak mbasdite që kishte ngelur s'u mora me të. Nata erdhi pa u ndier bashkë me një erë të ftohtë që shtynte në drejtimin tonë ca re të errëta. Me sa dukej dimri s'donte t'ia linte vendin pranverës; ditën dukej sikur mundej po natën thinjoshi i sertë e rimmerre veten.

Gjumi s'po na merrte. Unë po u tregoja djemve se si u pajtova me Ketrin.

— Mjaft, — u dëgjua zëri i komandantit, — mjaft, sot, me sa duket, e paskeni përzënë gjumin nga sytë.

— E lamë, — u dëgjua një zë. Heshtëm. E ndërkaq njëri pas tjetrit na zuri gjumi.

— Gjumë, Besnik vëllai, gjumë, po ti e di gjumin buzë kufirit. Të qëllon të flesh tri orë apo katër, po kurrë s'e ndien veten të pangopur. S'ka vend atje për asnjë lloj pretendimi e jo madje...

Kështu ndodhi edhe atë natë. Kishim fjetur a s'kishim fjetur katër orë, kur ja alarm, e alarmi i kufirit si alarmi i kufirit, më burrë s'ka ku e ndien veten njeriu. Sekonda ishin ato e ne dolëm jashtë. Çdo gjë u bë e qartë me shpejtësinë e vetëtimës: tre shkelës kufiri ishin parë te Shpella e Ujkut. U drejtova për te Ketri. Ketri, ç'zgjuarsi, ç'nuhatje kishte ai për gjëra të tilla. Fërkonte putrën te dera. Qimja e murme i ishte ngritur, sytë i shndritnin po nuk hungronte, se

e dinte ai ç'do të thoshte zhurmë në situata të tilla. E nxora, ai u hodh drejt e te dera e jashtme e oborrit. «Me një shok të tillë, i thoshe çdo së keqeje «ndal!»

— Ndiqi, — dëgjova zërin e komandantit, — ne po zëmë shtigjet.

Rrëshqitëm poshtë pyllit, Ketri ecte para, ta shikoje, Besnik, ta shikoje ç'lëvizje bënte ai tup, çante ç'gjente përpara, pa pyetur për shkurret dhe gëmushat, ecte me një siguri të tillë si të ishte mesditë. Kur e shikonte se më kishte lënë prapa, kthehej tërë krenari dhe plot sinjeritet më ftonte t'a ndiqja.

Dëgjova një krismë, pastaj një breshëri të tërë. «Ua gjetëm gjurmët», thashë dhe s'isha gabuar. Ndër-sa shkelësit mundoheshin të çanin, dara jonë i kishte futur në mes. Të kapur nga tmerri i vdekjes, derrat s'dinin ku e futnin noçkën. Njëri ishte shtrirë nga goditja e pritës sonë. Dy të tjerët ishin futur në mes të pyllit duke u ngatërruar me trungjet e pishave. Jo shumë larg, Ketri i kishte zbuluar, tani ai ecte duke u zvarritur, duke rrëshqitur si ngjalë e duke u maskuar për mrekulli.

I pashë të dy shkelësit, zura një vend të mirë, nga ku mund t'i kontrolloja e thirra rreptë:

— Duart lart!

Në atë kohë breshëritë e automatikëve të tyre u puthën diku. Hapa zjarr dhe unë. Breshëria ime e kapi njërin prej tyre dhe ai duke lëshuar një «o . . . o» u përplas përtokë. Por as unë s'kisha dalë pa gjë, në krah të djathtë kisha marrë një plagë, që dalngadalë po ftohej e po më shkrehte të gjithë muskujt.

Dhembja po më hynte deri në palcë, ai tjetri më kishte futur me siguri në rrethin e tytës së tij, armën s'po e ngrija dot dhe e shkrehu kuturu, më shumë për t'u rrëfyer udhën shokëve. Shkelësin s'e kisha

larg, ndoshta ai pa e ditur as vetë u ndodh mbi kokën time, e u bë gati të ma shkruhe, po s'mundi. S'mundi, Besnik, jo, Ketri bëri një kërcim të habitshëm e fluturimthi i përfshiu atij pulsën e dorës që mbante armën. Shkelësi u tmerrua e, siç qe, i dha dorës, po s'arriti të bënte gjë, sepse miku ynë ia ngjeshi putrat në gjoks dhe e rrëzoi përdhe, pastaj një hungurimë e fuqishme, ca kërcitje të tmerrshme dhëmbësh dhe një sulm i befasishëm ndaj kundërshtarit po e shpinin shkelësin në humbje të sigurtë. Po mendja bën hatanë, shkelësi nxori me dorën e majtë një thikë, tehu i saj shkëlqeu në errësirë. E pashë me sytë e mi, më erdhi të kafshoja veten me dhëmbë që s'po e ndihmoja dot Ketrin. Mua më merreshin mendtë, plaga më digjte e lëvizjen e kisha të pamundur. Bëra një përçapje, munda të zvarritesha paksa, por u preva përsëri dhe vetëm thirra: «kujdes, Ketër!» Zëri më doli i dobët dhe s'mbaj mend gjë. Kisha humbur gjak dhe kisha rënë në kllapi. Kur erdha në vete, e kishim kaluar pyllin. Shokët më kishin bërë një mjekim të shpejtë. U përpoqa të qëndroja ndenjor, po s'munda.

«— Do të të kalojë, — tha komandanti, — mos u bëj merak.

— Të gjithë jemi? — e pyeta.

— Si molla, — tha ai, — si molla, ja shikoji.

I buzëqeshëm njëri-tjetrit.

— Ketri? — pyeta unë. Ketri ku është?

— Ja, — treguan ata.»

Në fund të këmbëve të mia qëndronte ai. Për një çast e ndjeva veten njeriun më të gëzuar të botës, po ky ishte vetëm një zhgënjim.

«Ketër!» thirra. Sytë i mbante të mbyllur. Me të dëgjuar zërin tim u mundua të ngrihej më këmbë,

po s'mundi, i kishte rrjedhur shumë gjak e muskujt i ishin shkrehur fare. E ndjeva se i erdhi zor, sepse më shumë përpjekje, me shumë vështirësi m'u afrua.

«Kaq plagë e madhe ishte?» — pyeta shokët, kur pashë mjekimin në trupin e Ketrit.

Ata s'folën, se s'qe nevoja të flitnin.

«— Mos u mërzit, — tha komandanti, — gjendja jote nuk duron dot.»

Në atë kohë Ketri mbështeti kokën mbi trupin tim, pastaj hapi me forcë kapakët e syve, hungroi pakëz me zë të shuar, e lëvizi buzën e sipërme sikur të donte të më buzëqeshte. E lëmovava mirë e mirë, i pushtova qafën, atë çast kapakët e syve iu drodhën dhe iu mbyllën, tërë trupi u shkreh e ra mbi trupin tim.

— E pat, — thashë e diçka si një rrymë korenti më përshkoi trupin. E kisha humbur përsëri. Kur po ngjitnim të përpjetën e postës, u përmenda, kishte zbardhur, nga e majta e malit vetulla e diellit filloi të hidhte rrezet mbi supet tona.»

— Kjo ishte e tëra, Besnik vëllai, kjo ishte, harrroje po deshe!

— S'ke si e harron, — fola, — një miqësi e tillë të ushqen zemrën.

Në atë kohë lëvizja e trenit u ngadalësua derisa diku heshti fare. Unë duhej të zbritja.

RRËFIMI I NOKËS

Atë vit punën fizike e bëra në fermë. Brigadieri më tha të takoja Noken. U largova dhe pranë një kanali nja dy metra të thellë, ku punonin dy burra, pyeta:

— Kush është Nokja?

— Unë! — tha njëri prej tyre.

Ai që u përgjigj kishte një fytyrë të zeshkët dhe mustaqet pis të zeza. Në anën e majtë të gojës, futur mes dhëmbësh të bardhë e të rregullt, ndriste një dhëmb i verdhë.

— Hajde, — tha Nokja, — hajde. Mos do të bësh punën fizike këtë muaj këtu?

— Po, — u përgjigja duke vënë buzën në gaz.

Hyra në kanal, mora lopatën dhe fillova nga puna.

Në drekë bënin një orë pushim. Porsa ra çanga, nja dy vajza u larguan nga vendi i punës së tyre dhe erdhën te ne. Njëra vinte në fytyrë si Nokja, e zeshkët e me buzët në ngjyrën e qershisë, pak të dala, tjetra, një pikaloshë e me fytyrë të hollë, mbante mbi kokë një shami të qëndisur.

— Noke, — foli zeshkania, — a e ke marrë violinën?

— Nokja pa violinë si peshku pa ujë, — më sqaroi Faiku me të cilin punova.

Unë, që s'i njihja mirë, qesha.

— Hajde, — më thirri mua, — se zakonisht bëjmë zjarr, thekim bukën dhe..., — Nokja s'foli më, por lëvizi krahët në formën që marrin kur kapin violinën.

Qesha dhe bashkë me Faikun i vajtëm nga pas.

Zeshkania me pikaloshen po ndiznin zjarrin. Erdhën edhe punëtorë të tjerë. Një grua pak e thyer, që kishte mbështetur krahun mbi një gjym, herë pas here rrudhte buzët e rreshkëta dhe i frynte zjarrit.

Ata të gjithë nxorën para drekën. E nxori dhe Nokja dhe e vuri bukën të thekej pas zjarrit.

— Theke, theke edhe ti, se kështu të kuqen faqet, — më tha Nokja duke qeshur.

Mua po më vinte zor t'i nxirrja ato dy fetat e holla, po Nokja s'e zgjati shumë: ua hoqi letrën dy fetave të mia dhe i vuri pranë zjarrit.

— Noke, merre, de, të shkretën, — tha zeshkania.

— Nepi, ti si shumë e urdhëron Noken! — foli Faiku.

Zeshkania qeshi e uli kokën. Nokja sepse fërkoi duart. Sytë e zinj i ndritën dhe mori violinën. Tingujt e saj erdhën dalngadalë, duke u forcuar, si t'i dërgonte njeri nga larg. E pastaj u bënë më të fuqishëm dhe e detyruan zhurmën rreth zjarrit të heshtte. Më vonë Nokja ngriti zërin. Ai u bë një me tingujt e violinës:

*Syri yt i zi
Natës ia kalonte,*

*Buza si qershë
Zemrën ma copëtonte.*

Herë pas here lëvizja kokën. Ndeshja me shikimet e të tjerëve dhe vinim paksa buzën në gaz. Ndërsa zeshkania që dhënë e tëra pas Nokes.

Nokja nuk shikonte përreth, sytë e tij ëmbëlsisht ndiqnin lëvizjen e gishtave dhe të harkut të violinës. Buka pranë zjarrit po lëshonte tym; e largova dhe ndërkohë dëgjova zërin e Nokes që u drodh, mori një kthesë e dalngadalë ra; heshti, dhe violina u lëshua mbi gjunjë.

— E, e, — bëri Nokja, e vetullat i shkuan lart.

I buzëqesha dhe i rraha shpatullat. Të tjerët nuk e falenderuan Noken, duartrokitje e bravo s'pati. Po sa pa rëndësi do të dukeshin ato para asaj që shprehnin sytë dhe fytyrat e tyre. Me sa merrej vesh, Nokja i kishte mësuar ata me një ushqim të tillë.

— A ke dashuruar ndonjëherë? — më pyeti Nokja.

— Më erdhi e papritur kjo pyetje dhe në fillim e humba. «Ç'është kjo pyetje?» «Si mund të flasësh për këtë në sytë e të gjithëve? Si i erdhi Nokes?» Por ai priste përgjigje.

— Po, — i thashë.

— E humbe apo e fitove?

— Pse? — vura buzën në gaz nga këto pyetje dhe gjithë duke qeshur iu përgjigja: — E fitova.

— Të lumtë, — tha Nokja dhe duke psherëtirë foli: — Unë e humba, e humba, — dhe në fytyrën e Nokes zuri vend trishtimi. Sa i papërligjur m'u duk trishtimi mbi atë ballë të gjerë dhe mbi atë fytyrë të qeshur.

— Histori e largët, — tha Nokja dhe duke parë

nga zeshkania e mori violinën. Ajo uli kokën dhe u çua.

Nokja lëshoi violinën me forcë përdhe dhe foli ashpër:

— Ja pse u ndamë, ose më mirë, pse e humba. Dëgjoje, dëgjoje, — e sytë nuk ia ndante zeshkanes aq sa ajo u detyrua të ulej përsëri.

«Unë atëherë nuk punoja. As unë, as Faiku. Na kishin thënë të hynim në punë, në fermë apo ku të donim, po ne jo e jo. Paraja e dasmës, para e thatë i thoshim ne, na tërhiqte me një forcë të çuditshme. Nuk e di a e ke dëgjuar atë këngën:

*Ahengxhi, ku flejte mbramë,
Rrugë më rrugë e han më han.*

Të tillë ishim, po kot nuk thonë: atë që të bën koka, s'ta bën bota. Unë i bija violinës, Faiku klarinetës. Me ne ishin dhe dy të tjerë. Një natë vjeshte ishim në një fshat. Bëhej dasmë, po ç'dasmë thua ti, buronte rakia, or t'u bëfsha, buronte. Në atë shtëpi e njoha atë. «Belkëputura» kështu i thoshim ne. Faiku i thirri i pari me këtë emër. Ajo kërcente dhe beli i përkulej si vllastar pjergulle. M'u duk sikur në të gjitha dasmat kisha kërkuar atë dhe ja, më në fund, e kisha gjetur. E shikoja e më shikonte. Sytë i kisha të skuqur, por atë natë nuk i mbylla. Mbi violinë e gdhiva.

Të nesërmen s'e pashë; nuk ishte bijë e asaj shtëpie. E unë, si ahengxhi, fillova avazin. Po sytë e asaj nuk më largoheshin, më dukej sikur i mbaja mbi telat e violinës. Nuk më linte as Faiku rehat: «Se ç'kishte ajo belkëputura me ty» — më thoshte. «Bukë e fortë ajo», — i përgjigjesha unë.

Mbas një jave vajtëm po në atë fshat. Kur iu afruam shtëpisë ku ishim thirrur, unë u shtanga: sytë e ëmbël që s'më ishin ndarë për asnjë çast, më dolën para. Ajo qeshi dhe u ngjit nëpër shkallë. Edhe atë natë kërceu. S'm'u durua. U çova edhe unë. Kur e kapa për dore, sikur më ra zjarri. Kisha kërcyer bukur atë natë. Gojë hapur kishin mbetur dasmorët. Faiku m'i tha këto.

Në mëngjes ajo më hodhi të laja sytë. Unë ngrita kokën dhe e pashë. Ajo kishte kohë që më shikonte. Uji i gjymit rridhte nëpër pllaka e unë fërkoja duart ashtu, kot.

— Afroji, — tha ajo e buzët iu drodhën.

U bëra gati të flitja po s'shqiptova dot asnjë fjalë. Diçka e thatë ma mbushi gojën. E kapa për dore. Ajo u drodh. Psherëtiu. Gjoksi që më rrinte para syve u ul dhe u ngrit. Gjymi i ra nga dora dhe trokëlliti nëpër pllaka.

— Të dua, — i thashë. Mbase s'dija ç't'i thosha tjetër, apo ajo që duhej thënë u tha. A ku di unë!

Ajo i dha kokës pjerrtas dhe u largua. Unë shkunda duart, qeshja dhe ndihesha i lumtur sa s'bëhej.

U takuam pas dy ditësh. Doja t'i flitja, të paktën t'i thosha ato, që i kisha thënë aq herë me vete, po qe e pamundur. Unë, që vetëm kur haja bukë nuk flitja, para asaj isha kthyer në memec. Po një ditë folëm.

— Noke, — më foli ajo, — ti vetë e këndon atë këngën: ahengxi, ku flejte mbramë, rrugë më rrugë e han më han. Nuk kalohet jeta kështu, Noke. Pse veçohesh nga të tjerët? Po nuk të pëlqeu të punosh në qytet, hajde te ne. Kooperativa jonë dy muaj ka që është krijuar. Vërtet është e re, por edhe neve

na duhet një grup muzikantësh. S'ke pse të bre-
dhësh më.

— Mirë, — fola, — mirë, kështu le të bëhet.

U largova i gëzuar nga ajo dhe me mendje të
mbledhur se do t'ia plotësoja dëshirën.

I thashë Faikut vendimin, po ky nuk desh.

«Rri, Noke, se nuk të ka kërcitur beli ty. Pse
ç'e di punën ti, tavolinë me meze e raki, apo valle
dyshe? Zanati ynë është ahengu».

Fjalët e Faikut më lëkundën dhe punën tjetër e
bënë dasmat lumë të asaj vjeshte. Ato më thithën,
më ndillnin si atë qenin që ia kanë bërë benë për
ta vrarë dhe e gënjejnë me një copë mish e ai i
shkreti pa e ditur së ç'helm ka ajo, vete e ngul dhë-
mbët mbi të. «Të mbledh para dhe këtë vjeshtë,» i
dhashë karar me vete «dhe pastaj e kam më të lehtë
ta kërkoj në shtëpi». Dhe ashtu bëra, ndonëse më
vonë e ndjeva që kisha gabuar rëndë. Megjithëse ki-
shte kaluar një kohë e gjatë dhe përgjigje s'i kisha
dhënë, prapëseprapë doja ta takoja. Hymë në fshat
me Faikun, i cili tërë rrugës tallej me mua. Shkuam
te një miku ynë dhe pa e zgjatur shumë e hodhëm
llafin atje ku na interesonte. Përgjigjja e tij qe një
goditje e rëndë për mua. As vetë s'e di si qëndrova,
vetëm mbaj mend që tërë dhoma m'u soll qark dhe
për disa çaste mbeta si i humbur. Ajo ishte martuar
para një jave.

— E, o Noke, t'u mbush mendja që ajo s'të do-
nte? — Faiku e tha këtë për të më lehtësuar gjend-
jen dhe, ngaqë unë s'iu përgjigjja, vazhdoi: — S'duan
nga soji ynë ato, jo, hiqe mendjen.

S'durova më por kërceva dhe e mbërtheva Fai-
kun

— Nga i di ti këto, — kërcita dhëmbët unë.

E urreva Faikun, e urreva me tërë forcën e shpirtit atë çast. Pse shpifte? Pse fliste ashtu, kur ajo më qe lutur mua budallait? Ky ç'kishte? Apo donte të më shkulte zemrën.

Nuk e zgjata më shumë po mora violinën dhe i dërmuar shpirtërisht dola në rrugë. Ecja kuturu. Faiku më ishte qepur pas. Inati filloi të më binte, ndonëse në zemër nuk kisha më Faikun e parë. Eca përsëri në rrugën e ahengut. Violina më dukej e rëndë si qysqi. Qëllonte që dhe netët i kalonim jashtë. E, po të ketë ndonjë që i ka numëruar yjet, ja, unë jam. I përcillja ato me sy derisa zbardhte mëngjesi. Natën isha zënë me veten, isha zënë dhe me Faikun. Kjo gjendje ma kishte gërryer gëzimin nga vetja. Natën merrja vendim të largohesha, të merrte fund njëherë e përgjithmonë kjo jetë prej endacaku. Si mund ta gëzosh tjetrin kur vetë s'je i gëzuar? Po me të ardhur dita, bëja ndryshe: pritja ndonjë dasmë, siç pret zagari lepurin. Po dhe dasmat filluan të mos bëheshin më si dikur. Në fshat na thirrën ata të kooperativës dhe na propozuan të na merrnin në punë. Kësaj here vendosa. Rrëmbeva violinën dhe e përplasa mbas një trangu, ja, shikoje, edhe sot e ka shenjën». — Dhe Nokja më tregoi një gropë në pjesën anësore të violinës.

«Faiku, që s'më ndahej, më pa dhe më tha:

— Ç'pate?! — dhe mori violinën e ma zgjati.

— S'kam ç'e dua, — i thashë, — s'është më për atë punë që mendon ti, jo. Unë s'të vi më nga prapa, prandaj e copëtova. Ti po deshe të vazhdosh, vazhdo, por dije se vitet ikin dhe këmbët mbas zjarrit kurrë s'ke për t'i vënë. A nuk e shikon se kemi mbetur të fundit? Në të gjitha këto fshatra vetëm ne kullotim:

këmbët na ranë dhe shëndeti poshtë e më poshtë po vete...

Kështu i fola, mora violinën, telat e këputur kuisën. I mblodha shuk e i futa në xhep.

Ika dhe nga prapa ndjeva hapat e Faikut. Ika dhe ja, sot jam këtu. Si nata me ditën më duket vetja. Punoj dhe violinës i bie, pa le, po kam mësuar dhe ca këngë të reja. Ç'ta zgjat më, bukur e mirë jam.»

— Noke! — i thirra, porsa mbaroi fjalën e fundit. — Noke, ashtu siç e the dhe vetë, bukur e mirë je, por ama të duhet dhe diçka, mendoj unë, të duhet dhe s'ke pse ta humbasësh më.

— E ka gjetur, e ka gjetur, — tha një nga punëtorët e qeshi.

Ndërkohë qeshën dhe të tjerët. Me të dëgjuar këto fjalë, sytë më vajtën te zeshkania që pjerrtas shikonte nga Nokja dhe buzëqeshte.

Edhe Nokja qeshte, qeshte dhe dhëmbi i verdhë herë-herë i shndriste. Pastaj ai mori shpejt violinën, i ra asaj e këndoi:

*Në degë të bajames
Ç'po këndon bilbili,
Do të marr unë ty,
Porsa të hyjë prilli.*

Me të mbaruar vargu i fundit, shpërthyen duartrokkitje dhe të qeshura. Me këngën e parë s'ndodhi kështu! U kuptua qartë: Nokja i improvizoi vargjet aty për aty.

Ne u çuam të gjithë më këmbë dhe duke qeshur u drejtuan për te vendi i punës.

Brigadieri u afrua e po bënte çudi me ne. Deshi s'deshi vuri dhe ai buzën në gaz. Na vështroi të gjithë me radhë, po shikimi i tij ndali më shumë mbi Noken dhe zeshkanen.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Njohje	3
Nxënës dhe shokë	11
Mjeshtri	20
Mihali	26
Dasmë andej e grurë këtej	33
Në rrugën e vëllait	41
Ai u kthye përsëri	53
Tanku doli në kodër	63
Ketri	72
Rrëfimi i Nokes	79